




Co-funded by
the European Union



german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Udhëzime për produktet e ndërtimit

Udhëzime për zbatimin e Rregullores së BE-së për
Produktet e Ndërtimit (2011/305/BE)



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

TABELA E PËRMBAJTJES

Akronime dhe shkurtime	6
1. PAJTUESHMËRIA E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT NË TREGUN EVROPIAN (METODA ME PESË HAPA)	7
1.1 Të përgjithshme	7
1.2 Kërkesat bazë për performancat e produkteve të ndërtimit	9
1.3 Procedura e vlerësimit të konformitetit e CPR-së	11
1.3.1 Hapi i parë: Identifikimi i standardit të harmonizuar përkatës	12
1.3.2 Hapi i dytë: Shqyrtimi i karakteristikave themelore	12
1.3.3 Hapi i tretë: Testimi fillestar i tipit dhe kontrolli i prodhimit në fabrikë	13
1.3.4 Hapi i katërt: Deklarata e performancës	13
1.3.5 Hapi i pestë: Markimi CE	14
1.4 Sistemet e vlerësimit dhe vërtetimit të qëndrueshmërisë së performancës (AVCP)	14
1.4.1 Organet e përfshira në vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës	16
1.5 Standardet e harmonizuara	17
2. ROLI I STANDARDEVE NË PROJEKTIMIN E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT	18
2.1 Të përgjithshme	18
2.1 Struktura e standardit (hEN)	18
3. VLERËSIMI I KONFORMITETIT NË KUADËR TË CPR-SË	20
3.1 Të përgjithshme	20
3.2 Procedura e vlerësimit të brendshëm të konformitetit	21
4. Testimi fillestar i tipit	22
4.1 Pajisjet e testimit për vlerësimin e pajtueshmërisë	22
5. Kontrolli i prodhimit në fabrikë	24
5.1 Të përgjithshme	24
5.2 Manuali i kontrollit të prodhimit në fabrikë	24
5.2.1 Të përgjithshme	25
5.2.2 Pajisjet e testimit dhe pajisjet matëse	25
5.2.3 Pajisjet e prodhimit	25
5.2.4 Lëndët e para	25
5.2.5 Procesi i prodhimit	26
5.2.6 Testimi i produkteve të përfunduara	26
5.2.7 Markimi dhe kontrolli i stokut të produkteve	26
5.2.8 Produktet jokonforme	26
5.3 Procedurat e thjeshtuara nga ndërmarrjet mikro	26
5.3.1 Përdorimi i dokumentacionit teknik të përshtatshëm - Neni 36	26
5.3.2 Përdorimi i procedurave të thjeshtuara nga ndërmarrjet mikro - Neni	27
5.3.3 Procedura të tjera të thjeshtuara - Neni 38	28

6. DEKLARATA E PERFORMANCËS DHE MARKIMI CE	28
6.1 Deklarata e performancës CE	28
6.2 Markimi CE për produktet e ndërtimit	30
7. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT PËR PRODUKTET JO TË HARMONIZUARA	31
7.1 Faktet lidhur me procedurën (rrugën) e ETA-s	32
8 AKSESI NË TREGUN E BRENDSHËM TË BE-SË	33
8.1 Lëvizja e lirë e mallrave	36
8.2 Njohja e ndërsjellë	37
8.3 Pikat e kontaktit të produkteve për produktet e ndërtimit – Neni 10	37
8.4 Dokumenti udhëzues për zbatimin e Rregullores (BE) 2019/515	38
9. MBIKËQYRJA E TREGUT dhe PRODUKTET E RREZIKSHME	39
9.1 Shkëmbimi i shpejtë i informacionit për produktet e rrezikshme (Safety Gate, ish- baza e të dhënave RAPEX)	40
9.1.1. Projekti SEED+	40
10. UDHËZIME TË MËTEJSHME PËR PËRDORIMIN E CPR-SË SË RE	41
11. BIBLIOGRAFIA	42

LEXONI DEKLARATAT E MËPOSHTME PËR MOHIMIN E PËRGJEGJËSISË

Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë:

- 01.** Ky është një dokument udhëzues për operatorët ekonomikë që duhet të respektojnë rregulloret e brendshme të shteteve palë që zbatojnë CPR-në (2011/305/BE)¹, si dhe për të gjithë prodhuesit në shtetet palë të CEFTA-s që eksportojnë produktet e tyre të ndërtimit në Tregun e Brendshëm Evropian. Krahas vetë CPR-së, dokumentet me fuqi ligjore detyruese janë dy akte të deleguara, Rregullorja e deleguar e BE-së nr. 568/2014 "Për vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit" dhe Rregullorja e deleguar e BE-së nr. 574/2014 "Për modelin që do të përdoret për hartimin e një deklaratë të performancës për produktet e ndërtimit" dhe, sipas rastit, dokumentet shoqëruese të mandatuara të lëshuara nga ligjvënësit dhe rregullatorët e shteteve palë përkatëse.
- 02.** Standardet dhe dokumentet ligjore të përmendura në tekst i referohen versionit që është në fuqi në datën e këtyre udhëzimeve. Megjithatë, për përdorimin e dokumenteve dhe standardeve ligjore, duhet të verifikohet dhe të përdoret versioni i tyre në fuqi.
- 03.** Ky dokument, i cili shërben si udhëzues për markimin CE të produkteve të ndërtimit, nuk përfshin situata specifike për shkak të nivelit të zbatimit të akteve legjislative evropiane në shtetet palë të CEFTA-s.
- 04.** Udhëzimet përdorin folje në kohën e tashme për të përshkruar kërkesat që burojnë nga dokumentet ligjore dhe foljen gjysmëndihmëse "duhet" për të përshkruar mënyrat fakultative të përmbushjes së kërkesave.
- 05.** Këto udhëzime janë hartuar për të ndihmuar operatorët ekonomikë dhe grupet e tjera të interesit të infrastrukturës së cilësisë që të kuptojnë më mirë zbatimin e Rregulloreve për Produktet e Ndërtimit. Krerët 1 deri në 6 dhe kreu 10 u drejtohen kryesisht prodhuesve, ndërsa Krerët 7 dhe 8 u drejtohen OVK-ve që operojnë në sektorin e produkteve të ndërtimit.

Akronime dhe shkurtime

Akronimi/ shkurtimi	Shpjegimi
CAB	Organi i vlerësimit të konformitetit
CEFTA	Marrëveshja për Tregtinë e Lirë në Evropën Qendrore
CEN	Comité Européen de Normalisation / Komiteti Evropian për Standardizimin
CENELEC	Comité Européen de Normalisation Électrotechnique / Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik
CNB	Koordinimi i organeve të notifikuara
CPR	Rregullorja për Produktet e Ndërtimit
EA	Bashkëpunimi evropian për akreditimin
EU (EC)	Bashkimi Evropian (Komuniteti Evropian)
FPC	Kontrolli i prodhimit në fabrikë
hEN	Standardi evropian i harmonizuar
ICSMS	Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit për Mbikëqyrjen e Tregut
IMS	Sistemi i integruar i prodhimit
MD	Direktiva për makineritë
NAB	Organi kombëtar i akreditimit
NANDO	Organizatat e Notifikuara dhe të Përcaktuara të Qasjes së Re
NB	Organ i notifikuar
NLF	Kuadri i ri legjislativ
PL	Niveli i performancës
QI	Infrastruktura e cilësisë
RAPEX	Sistemi i sinjalizimit të shpejtë i BE-së për produktet e rrezikshme të konsumit
SAFETY GATE	Sistemi i ri i sinjalizimit të shpejtë (ish-RAPEX)
SEED+	Baza e të dhënave të produkteve të pasigurta dhe të papajtueshme në tregun e CEFTA-s
TCF	Dosja teknike e ndërtimit
TFEU	Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian

1. PAJTUESHMËRIA E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT NË TREGUN EVROPIAN (METODA ME PESË HAPA)

1.1 Të përgjithshme

Rregullorja për Produktet e Ndërtimit - CPR (2011/305/BE) përcakton rregulla të harmonizuara për tregtimin e produkteve të ndërtimit në BE. Ajo ka pësuar ndryshime me anë të 20 akteve të deleguara dhe një rregulloreje zbatuese. Ndër aktet më të rëndësishme për prodhuesit janë:

- Rregullorja e deleguar 568/2014/BE, **"Për vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit" – AVCP**, dhe
- Rregullorja e deleguar (574/2014/BE) **"Për modelin që do të përdoret për hartimin e një deklarate të performancës për produktet e ndërtimit"**.
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 1062/2013 "Për formatin e vlerësimeve teknike evropiane".

Rregullorja krijon një gjuhë të përbashkët teknike për vlerësimin e performancës së produkteve të ndërtimit. Ajo siguron që profesionistëve, autoriteteve publike dhe konsumatorëve t'u vihen në dispozicion informacione të besueshme, në mënyrë që ata të mund të krahasojnë performancën e produkteve nga prodhues të ndryshëm në vende të ndryshme.

Kjo rregullore parashton kushtet për hedhjen ose vënien në dispozicion në treg të produkteve të ndërtimit, duke vendosur

rregulla të harmonizuara mbi mënyrën sesi duhet shprehur performanca e produkteve të ndërtimit në lidhje me karakteristikat e tyre themelore dhe mbi përdorimin e markimit CE në këto produkte në tregun e brendshëm të BE-së.

Aktet e deleguara fokusohen në kategori specifike produktesh dhe në mënyrën se si duhet të vlerësohet performanca e tyre:

- reagimi ndaj zjarrit (p.sh. në rastin e produkteve prej druri, lëndës drusore të laminuar me ngjitës, suvatimeve të jashtme),
- kategoritë e performancës (për aspekte të veçanta të disa produkteve, siç është përçueshmëria e ajrit për elementet e çatave ose rezistenca ndaj erës për grilat e jashtme),
- sistemet e vlerësimit dhe të vërtetimit (p.sh. për kanalet e ajrit, për panelet-sanduiç me faqe të jashtme metalike ose për pajisjet për mbrojtje nga rënia),
- klasifikimi pa testim, në rast se produktet përmbushin kritere të caktuara në bazë të standardeve të harmonizuara.

Kur prodhuesit ndjekin kërkesat e standardeve të harmonizuara, kjo çon automatikisht në prezumimin e konformitetit me Rregulloren për Produktet e Ndërtimit.



Co-funded by
the European Union



german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Legjislacioni evropian për produktet e ndërtimit

*KUADRI I PËRBASHKËT i bazuar në situatën aktuale të legjislacionit të BE-së dhe rregulloreve të brendshme të shteteve palë të CEFTA-s (prill 2024)

RREGULLORJA E DELEGUAR

nr. 568/2014/BE

"PËR VLERËSIMIN DHE VERIFIKIMIN E QËNDRUESHMËRISË SË PERFORMANCËS"

RREGULLORJA 305/2011/BE*

Kushtet për tregtimin e produkteve të ndërtimit
ZONA E HARMONIZUAR

RREGULLORJA E DELEGUAR

nr. 574/2014/BE

HARTIMI I NJË DEKLARATE PERFORMANCE

RREGULLORJA (BE) 2019/515

"Për njohjen e ndërsjellë të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar dhe për shfuqizimin e Rregullores (BE) nr. 764/2008"

RREGULLORJA (BE) 765/2008

"Për kërkesat për akreditim në lidhje me tregtimin e produkteve"

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

MUNDËSI TREGTIMI PËR PRODHUESIT

CILËSIA E MALLRAVE, SIGURIA E PËRDORUESVE

RREGULLORJA (BE) 1020/2019

MBIKËQYRJA E TREGUT DHE PAJTUESHMËRIA E PRODUKTEVE (që ndryshon 765/2008/BE, CPR-në, Direktivën për Makineritë)

Ligji për Produktet e Ndërtimit...

i zbatuar në secilin shtet palë ZONË JO E HARMONIZUAR

Ligji për kërkesat teknike për produktet teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit... zbatuar në secilin shtet palë

Baza ligjore për ZBATIMIN E DIREKTIVAVE DHE RREGULLOREVE TEKNIKE TË QASJES SË RE

Figura 1: Paraqitje skematike e legjislacionit të BE-së për produktet e ndërtimit

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

1.2 Kërkesat bazë për performancat e produkteve të ndërtimit



CPR-ja harmonizon metodën e vlerësimit të performancës së produkteve të ndërtimit dhe krijon kushte të harmonizuara për tregtimin e këtyre produkteve. Kur hedhin në treg produkte ndërtimi, operatorët ekonomikë duhet të sigurohen që ato të jenë në përputhje me standardet e harmonizuara në nivel BE-je. E njëjta gjë vlen për vendet e BE-së kur vendosin kërkesa për performancën e produkteve të ndërtimit. Markimi CE tregon se një produkt ndërtimi është në përputhje me performancën e tij të deklaruar.

Shtetet anëtare duhet të lejojnë tregtimin e këtyre produkteve pa qenë nevoja për asnjë testim, certifikatë apo markim të mëtejshëm, ndërsa në rajonin e CEFTA-s, disa shtete palë po imponojnë mbi produktet e importit, duke përfshirë edhe ato që mbartin markimin CE, një detyrim për njohjen e certifikimeve dhe rezultateve të testeve të furnizuesit.

Punimet e ndërtimit në tërësi, si dhe pjesët e tyre të mëvetësishme, duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të synuar,

duke pasur parasysh në veçanti shëndetin dhe sigurinë e personave të përfshirë në të gjitha hallkat e punimeve në ndërtesa, si dhe të atyre që banojnë në këto ndërtesa, për të siguruar banesa të sigurta dhe të shëndetshme.

Karakteristikat themelore të produkteve të ndërtimit, të përcaktuara në shtojcën I të CPR-së, janë:

- Rezistenca dhe qëndrueshmëria mekanike
- Siguria në rast zjarri
- Higjiena, shëndeti dhe mjedisi
- Siguria dhe aksesueshmëria në përdorim
- Mbrojtja nga zhurmat
- Kursimi i energjisë dhe ruajtja e nxehtësisë
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Kërkesat bazë për çdo tipose familje produktesh ndërtimi parashtrohen në standardet e harmonizuara (hEN-të). Për familje të veçanta të produkteve të ndërtimit që mbuloohen nga standardet e harmonizuara, përcaktohen karakteristikat themelore për të cilat prodhuesi deklaron performancën e produktit kur ai

hidhet në treg. Sipas rastit, përcaktohen edhe nivelet kufi të performancës në lidhje me karakteristikat themelore të deklaruara.

Prodhuesit janë përgjegjës për vlerësimin e performancës së një produkti për t'u siguruar se ai përmbush kërkesat e standardeve të publikuara në një listë shoqëruese të CPR-së. Sistemi për arritjen e konformitetit është i ndryshëm për produkte të ndryshme dhe varet nga standardet e harmonizuara për atë produkt specifik apo për atë familje produktesh.

Detyrimet e prodhuesve jepen në nenin 11 të CPR-së:

Prodhuesit:

- hartojnë deklaratën e performancës në përputhje me nenet 4 dhe 6 dhe vendosin markimin CE në përputhje me nenet 8 dhe 9;
- hartojnë dokumentacionin teknik që përshkruan të gjitha elementet përkatëse që lidhen me sistemin e kërkuar të vlerësimit dhe vërtetimit të qëndrueshmërisë së performancës [dhe e ruajnë atë për një periudhë deri në 10 vite];
- marrin në konsideratë të gjitha ndryshimet e tipit të produktit dhe hEN-ve;
- kryejnë testimin e mostrave të produkteve të ndërtimit të hedhura ose të vëna në dispozicion në treg, hetojnë dhe mbajnë një regjistër të ankesave, produkteve jo në konformitet dhe tërheqjeve të produkteve, si dhe mbajnë shpërndarësit të informuar për çdo monitorim të tillë;
- sigurohen që produktet e tyre të ndërtimit të mbartin tipin, numrin e lotit ose të serisë, emrin e tyre, emrin tregtar të regjistruar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën e tyre të kontaktit [cilësoni një pikë të vetme kontakti ku mund të kontaktohet prodhuesi];
- sigurohen që produkti të shoqërohet me udhëzime dhe informacione sigurie në një

gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga përdoruesit;

- për produktet që nuk janë në konformitet, marrin masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë atë produkt ndërtimi në konformitet, ose, sipas rastit, për ta tërhequr produktin nga tregu ose për të ndaluar tregtimin e tij;
- kur produkti paraqet rrezik, prodhuesit njoftojnë menjëherë autoritetet kompetente vendase dhe
- bashkëpunojnë me këto autoritete, me kërkesë të këtyre të fundit, lidhur me të gjitha masat e marra për eliminimin e rreziqeve që paraqesin produktet e ndërtimit që ata kanë hedhur në treg.

Zakonisht, për prodhuesit lindin disa pyetje kur ata nisin prodhimin dhe u duhet të marrin në konsideratë detyrimet e tyre përpara se t'i hedhin produktet në treg apo t'i integrojnë ato drejtpërdrejt në një ndërtesë. Këto pyetje janë:

- si mund të arrihet një qasje e organizuar ndaj projektimit dhe prodhimit të produkteve të ndërtimit në mënyrë të tillë që të përmbushen të gjitha kërkesat ligjore,
- si mund të sigurohet që të gjitha masat e zbatuara në procesin e prodhimit duke u bazuar në përdorimin e standardeve të harmonizuara për produktin dhe për testimin e performancës të jenë të duhura dhe të mjaftueshme,
- si të vlerësohet nëse janë përmbushur të gjitha detyrimet dhe kur nevojitet bashkëpunimi me një organ palë të tretë për vlerësimin e konformitetit.

Kreu i mëposhtëm, i shkruar në një gjuhë të qartë dhe juridike, jep udhëzime teknike specifike lidhur me mënyrën e përmbushjes së kërkesave në procedurën e vlerësimit me pesë hapa.

1.3 Procedura e vlerësimit të konformitetit e CPR-së

Le të shpjegojmë se çfarë nënkupton saktësisht metoda me pesë hapa për arritjen e konformitetit të produkteve si bazë për markimin përfundimtar CE të një produkti.

Prodhuesi kryen procedurën e vlerësimit dhe vërtetimit të qëndrueshmërisë së performancës (AVCP) sipas pesë hapave të mëposhtëm (shih Figurën 2):

- identifikon të gjitha dispozitat që rregullojnë dhe përcaktojnë qëndrueshmërinë e performancave sipas standardeve përkatëse të harmonizuara, pra identifikon AVCP-në përkatëse sipas Rregullores (BE) nr. 568/2014;

- shqyrton karakteristikat themelore dhe kontrollin e prodhimit në fabrikë (KPF), si dhe bashkëpunon sipas nevojës me një organ të notifikuar për certifikimin e KPF-së;
- kryen testimin fillestar të tipit nëpërmjet mostrave, sipas metodave të listuara dhe të shpjeguara në standardet e harmonizuara (hEN), si dhe kryen testimin e karakteristikave themelore përmes një organi të notifikuar, kur kërkohet përdorimi i një organi të notifikuar;
- plotëson dhe lëshon një deklaratë performance sipas rregullores (BE) nr. 574/2014 dhe
- vendos markimin CE mbi produktin përfundimtar dhe të pajtueshëm.




Figura 2: Diagrami i vlerësimit të konformitetit me pesë hapa për produktet e ndërtimit

1.3.1 Hapi i parë: Identifikimi i standardit të harmonizuar përkatës

Mënyra më e lehtë për të vërtetuar konformitetin e një produkti është përmes përdorimit të një standardi të harmonizuar, nëse ekziston një i tillë për produktin në fjalë. Kur prodhuesit duan të gjejnë kërkesat që zbatohen për një produkt të caktuar, hapi i parë është t'i referohen Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe të kërkojnë përditësimin më të fundit të publikuar të listës së hEN-ve, me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara, të cilat çojnë në prezumimin e konformitetit me CPR-në.

Nr.	Referenca ndaj standardit	Referenca ndaj standardit të zëvendësuar	Fillimi i periudhës së bashkekzistencës (dd.mm.vvv.)	Përfundimi i periudhës së bashkekzistencës (dd.mm.vvv.)
1.	LN 15824:2017 Specifikimet për suvatimet e jashtme dhe suvatimet e brendshme me bazë lidhësish organike	EN 15824:2009 Specifikimet për suvatimet e jashtme dhe suvatimet e brendshme me bazë lidhësish organike	9.3.2018.	9.3.2020.

Shembull: [VENDIMI ZBATUES I KOMISIONIT \(BE\) 2019/ 451 - datë 19 mars 2019 - "Për standardet e harmonizuara për produktet e ndërtimit", hartuar në mbështetje të Rregullores \(BE\) nr. 305 / 2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit \(europa.eu\)](#)

Prodhuesi duhet të vërtetojë nëse produkti i tij mbulohet nga objekti i standardeve të harmonizuara në fuqi, titujt e të cilave referohen në Gazetën Zyrtare (të BE-së ose të shteteve palë) dhe janë gjithashtu të disponueshme në faqet e internetit të organeve evropiane dhe kombëtare të standardizimit.

Referencat në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe cilësimi i periudhës së bashkekzistencës shërbejnë vetëm për t'i dhënë prodhuesit mundësinë të përdorë ose versionin e mëparshëm të standardit, ose versionin e rishikuar të tij për të përfituar nga prezumimi i konformitetit. Në të dyja rastet, vendosja e markimit CE ose e markimit vendas të konformitetit është e detyrueshme.

1.3.2 Hapi i dytë: Shqyrtimi i karakteristikave themelore

Vlerësimi i produktit bëhet duke përcaktuar vlerën e një liste karakteristikash të quajtura karakteristika themelore. Prodhuesi mund ta gjejë listën e plotë të tyre në shtojcën ZA të standardeve të harmonizuara. Lista mund të jetë e ndryshme për çdo përdorim të synuar dhe, në rastin e një produkti me më shumë se një përdorim të synuar, lista duhet të mbulojë karakteristikat e lidhura me secilin prej tyre. Lista përfshin gjithashtu sistemin AVCP për çdo karakteristikë themelore. Në varësi të sistemit AVCP, prodhuesit mund t'i duhet një ose disa organe të notifikuar për kryerjen e detyrave të lidhura me të. Udhëzime më të detajuara jepen më tej në këtë dokument.

1.3.3 Hapi i tretë: Testimi fillestar i tipit dhe kontrolli i prodhimit në fabrikë

Prodhuesi demonstroi pajtueshmërinë e produktit të tij me kërkesat përkatëse të çdo hEN-je të zbatueshme dhe me vlerat ose kategoritë e deklaruara për vetitë e produktit duke kryer të dyja detyrat e mëposhtme:

- a. Testimin fillestar të tipit të produktit (TFT)
- b. Kontrollin e prodhimit në fabrikë (KPF), duke përfshirë inspektimin e produktit.

SHËNIM: Pajtueshmëria me standardet e harmonizuara evropiane mund të vlerësohet edhe përmes testit të pranimit nga konsumatori, kur është rënë dakord kështu, ose përmes certifikimit nga një palë e tretë.

Testimi fillestar i tipit duhet të kryhet për të demonstruar konformitetin me standardet e harmonizuara evropiane. Të gjitha performancat përkatëse të përshkruara në hEN, konformiteti dhe përshtatshmëria e të cilave deklarohet nga prodhuesi, i nënshtrohen testimit fillestar të tipit.

Prodhuesi krijon, dokumenton dhe ruan një sistem (të brendshëm) të kontrollit të prodhimit në fabrikë (KPF) për të siguruar që produktet e hedhura në treg të jenë në përputhje me vlerat e kërkuara për çdo performancë, dhe e përdor atë edhe për prodhimin e rregullt.

Sistemi i KPF-së duhet të konsistojë në procedura, kontrole dhe teste periodike dhe/ose në vlerësim dhe zbatim të rezultateve për verifikimin e inputeve dhe lëndëve të para, pajisjeve, proceseve të prodhimit dhe produktit. Të gjitha elementet, kërkesat dhe parashikimet e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen sistematikisht në përputhje me procedurat dhe politikat e shkruara dhe të konsoliduara. Rezultatet e vlerësimit dhe kontrolli i prodhimit në fabrikë e lejojnë prodhuesin të vërtetojë dhe të japë prova se performancat nuk ndryshojnë me kalimin e kohës.

1.3.4 Hapi i katërt: Deklarata e performancës

Duke u bazuar në informacionin e mbledhur, dokumenti i parë që do të hartohet është deklarata e performancës. Ai është dokumenti më i rëndësishëm që merret për bazë për markimin CE, pasi përmban informacionin e plotë në lidhje me prodhuesin, produktin dhe performancat e tij, sipas kërkesave të standardit të harmonizuar përkatës. Për përgatitjen e formatit të tij individual për deklaratën e performancës së produkteve, prodhuesi duhet të ndjekë udhëzimet e publikuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Rregullorja e Deleguar (BE) nr. 574/2014 "Për modelin që duhet përdorur për hartimin e një deklaratë

performance për produktet e ndërtimit dhe për ndryshimin e shtojcës III të CPR-së". Deklarata e performancës përfshin një tabelë me specifikime lidhur me vlerat e deklaruara dhe ato të arritura të performancave, që shprehin pajtueshmërinë me kërkesat. Në fund, markimi CE do të konsistojë thjesht në një përmbledhje të informacionit të përfshirë në deklaratën e performancës.

1.3.5 Hapi i pestë: Markimi CE

Prodhuesi mund ta vendosë markimin CE duke u bazuar në deklaratën e performancës, pas plotësimit të kësaj të fundit. Specifikimet teknike që përkojnë me kërkesat themelore të CPR-së shpjegohen në shtojcën ZA të çdo standardi të harmonizuar në lidhje me një kategori produktesh. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar janë përgjegjës për vendosjen e markimit CE.

Markimi duhet të përmbajë si simbolin CE, ashtu edhe një paraqitje të informacionit lidhur me limitet e vlerave të arritura dhe të deklaruara të performancave me të cilat produktet përputhen.

Ky informacion është mjaft i rëndësishëm për përdoruesin fundor të produkteve të ndërtimit për të arritur performancat e duhura përfundimtare të ndërtesave, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Markimi vendoset mbi një njësi ose, kur kjo nuk është e mundur, mbi etiketën shoqëruese, mbi paketim ose në dokumentet tregtare shoqëruese, siç është fletë-dërgesa.

Rregullorja lejon gjithashtu edhe publikimin e versioneve dixhitale të deklaratës së performancës dhe të markimit CE në faqen e internetit të prodhuesit.

1.4 Sistemet e vlerësimit dhe vërtetimit të qëndrueshmërisë së performancës (AVCP)

Produktet e ndërtimit mbulojnë pothuajse 3000 produkte të larmishme dhe komplekse të cilat variojnë, për shembull, nga çimentoja, produktet e betonit, asfalti, agregatet, dritaret, dyert dhe tjegullat e çative, sistemet e detektimit të zjarrit dhe alarmet e tymit, e deri te trarët e çelikut për mbështetjen e strukturave. Nisur nga ky fakt, lind pyetja legjitime se cila është qasja që duhet përdorur ndaj këtyre kërkesave dhe cili është procesi i nevojshëm i vlerësimit të konformitetit për secilin produkt ndërtimi.

Pasi prodhuesi vërteton nëse ekziston një standard i harmonizuar që mbulon produktin e tij, si dhe një listë shoqëruese e karakteristikave themelore përkatëse për produktin, ai duhet të verifikojë se cilat janë procedurat që duhen ndjekur për deklarimin e performancës së çdo karakteristike themelore, si p.sh. metodat e testimit, vlerat e deklaruara etj. Prodhuesi është i detyruar të përdorë procedurat për testimin e mostrave dhe të përcaktojë kontrollin e detajuar të prodhimit në fabrikë për produktet e tij.

Në disa raste, sistemi AVCP që zbatohet për çdo karakteristikë themelore kërkon kryerjen e disa detyrave shtesë nga një organ i notifikuar. Në tabelën e mëposhtme (Figura 3), gjeni detyrat që prodhuesit dhe organet e notifikuara duhet të kryejnë në varësi të sistemit AVCP që përdoret nga standardi i harmonizuar.

SHËNIM: Sistemi AVCP quhej (AoC) në CPD, Direktiva e Këshillit 89/106/KEE, datë 21 dhjetor 1988, "Për produktet e ndërtimit".

Vlerësimi dhe vërtetimi i qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit në lidhje me karakteristikat e tyre themelore kryhet në përputhje me një nga sistemet e përcaktuara në shtojcën V të rregullores CPR.

Sistemi ose sistemet e përcaktuara kësisoj cilësohen në mandatet për standardet e harmonizuara (hEN) dhe në specifikimet teknike të harmonizuara (ETA).

Lloji i sistemit	Përgjegjësia	Lloji i organit të notifikuar	Detyrat
System 1+	Organi i notifikuar	Organi i certifikimit të produktit	Inspektimi fillestar i sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë Mbikëqyrja e vazhdueshme e sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë Përcaktimi i llojit të produktit Testimi auditues
	Prodhuesi		Kontrolli i prodhimit në fabrikë dhe testimi i mëtejshëm i mostrave
System I	Organi i notifikuar	Organi i certifikimit të produktit	Inspektimi fillestar i sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë Mbikëqyrja e vazhdueshme e sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë Përcaktimi i llojit të produktit
	Prodhuesi		Kontrolli i prodhimit në fabrikë dhe testimi i mëtejshëm i mostrave
System 2+	Organi i notifikuar	Organi i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë	Inspektimi fillestar i sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë Mbikëqyrja e vazhdueshme e sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë
	Prodhuesi		Kontrolli i prodhimit në fabrikë dhe testimi i mëtejshëm i mostrave Përcaktimi i llojit të produktit
System 3	Organi i notifikuar	Laborator testimi	Përcaktimi i llojit të produktit
	Prodhuesi		Kontrolli i prodhimit në fabrikë
System 4	Prodhuesi	Asnjë përfshirje e pavarur	Kontrolli i prodhimit në fabrikë Përcaktimi i llojit të produktit

Figura 3: Sistemet AVCP sipas llojit të organeve të notifikuara, përgjegjësi dhe detyrave që duhen kryer

Për produktet e përfshira në AVCP 3 ose 4, nuk është i nevojshëm bashkëpunimi dhe lidhja e një kontrate midis prodhuesit dhe një organi të notifikuar, por prodhuesit janë të detyruar të kryejnë vetë një kontroll të prodhimit në fabrikë (KPF). Thënë kjo, laboratorët e testimit do të kryenin në shumicën e rasteve vetëm një pjesë të vlerësimit të konformitetit që nevojitet për verifikimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit. Në varësi të standardit të zbatueshëm për produktin, marrja e mostrave për produkte të tilla si asfalti, betoni, përzierjet bituminoze, agregatet etj. kryhet zakonisht në terren (marrja e mostrave dhe testimi mbi produkte të prodhuara individualisht ose të personalizuar në kuadër të një procesi jo në seri) dhe në laboratorët e testimit të vetë prodhuesit me pajisjet e këtij të fundit, që mirëmbahen dhe kalibrohen rregullisht, ose

testimi kryhet nga një laborator i akredituar sipas ISO/IEC 17025.

Në rastin e AVCP 2+, 1 dhe 1+, është i detyrueshëm një vlerësim i mëtejshëm përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë (KPF) nga një organ i notifikuar si palë e tretë, duke përfshirë edhe arsyetimet përkatëse, që e kualifikon këtë vlerësim konformiteti si testim të produktit në procesin e certifikimit (akredituar sipas ISO/IEC 17065).

1.4.1 Organet e përfshira në vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës

Për sa i përket funksionit të organeve të notifikuara të përfshira në vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës për produktet e ndërtimit, bëhet dallimi midis:

- 01. organit të certifikimit të produktit:** një organ i notifikuar qeveritar ose joqeveritar, që zotëron kompetencën dhe përgjegjësinë e nevojshme për kryerjen e certifikimit të një produkti në përputhje me rregulla të caktuara të procedurës dhe menaxhimit.
- 02. organit të certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë:** një organ i notifikuar qeveritar ose joqeveritar, që zotëron kompetencën dhe përgjegjësinë e duhur për të kryer certifikimin e kontrollit të prodhimit në fabrikë në përputhje me rregulla të caktuara të procedurës dhe menaxhimit.
- 03. laboratorit të testimit:** një laborator i notifikuar i cili mat, ekzaminon, teston, kalibron ose përcakton ndryshe karakteristikat ose performancën e materialeve ose produkteve të ndërtimit.

Notifikimi i organeve të notifikuara dhe tërheqja e tyre janë përgjegjësi e shtetit anëtar notifikues të BE-së. Është përgjegjësi e shtetit anëtar të BE-së që të notifikojë organet e vlerësimit të konformitetit brenda juridiksionit të tij sipas parimeve të përcaktuara në [Vendimin 768/2008/KE](#)².

Organet e notifikuara

- janë të lira t'ia ofrojnë shërbimet e tyre të vlerësimit të konformitetit çdo operatori ekonomik brenda ose jashtë BE-së;
- mund t'i kryejnë këto veprimtari në territorin e vendeve të tjera të BE-së ose vendeve joanëtare të BE-së
- duhet të operojnë në mënyrë jodiskriminuese, transparente, neutrale, të pavarur dhe asnjëse;
- duhet të punësojnë personelin e nevojshëm

me njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për kryerjen e vlerësimit të konformitetit në përputhje me ligjin/ligjet në fjalë;

- duhet të marrin masa të përshtatshme për të garantuar konfidencialitetin e informacionit të marrë në kuadër të vlerësimit të konformitetit;
- duhet të jenë të pajisur me sigurimin e duhur që mbulon veprimtaritë e tyre profesionale, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia e tyre është e siguruar në bazë të legjislacionit kombëtar të shtetit notifikues të BE-së;
- duhet t'i japin informacione autoritetit të tyre notifikues, autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe organeve të tjera të notifikuara.

Prodhuesit janë të lirë të zgjedhin çdo organ të notifikuar që është caktuar ligjërisht për kryerjen e procedurës së vlerësimit të konformitetit.

Organet e notifikuara evropiane (New Approach Notified and Designated Organisations - Organizatat e Notifikuara dhe të Caktuara të Qasjes së Re), të caktuara/të njohura për kryerjen e detyrave në një treg evropian, përfshihen në bazën e të dhënave NANDO. Prodhuesit mund të përdorin një ose disa organe të notifikuara nga çdo shtet anëtar ose, kur prodhuesi nuk eksporton produkte në tregun evropian, ai mund të përdorë laboratorë të akredituar në secilin shtet palë të CEFTA-s.

Listat në [bazën e të dhënave të sistemit të informacionit NANDO](#)³ përfshijnë

- numrin e identifikimit të çdo organi të notifikuar
- detyrat për të cilat ai është notifikuar dhe
- përditësohen rregullisht.

The Procedura e kërkimit mund të kryhet sipas vendit, legjislacionit, dokumentit normativ ose si kërkim i lirë:

- [Kërkimi sipas vendit](#)
- [Kërkimi sipas legjislacionit](#)
- [Kërkim i lirë](#)

SHEMBUJ: Disa nga laboratorët e akredituar kryejnë teste fizike, kimike dhe mekanike për karakteristikat themelore, siç përcaktohet në specifikimet teknike të harmonizuara për përdorimin e synuar – sipas AVCP-ve të ndryshme për produktet e ndërtimit. Disa prej tyre përmenden në një tabelë, si për shembull:

Llaçi për muraturë, çimentoja, betoni, përzierjet e asfaltit, agregatet për beton. Agregatet e lehta për llaç, materialet izoluese etj. materialet e dheut, (gurët, dheu i imtë dhe dheu i trashë)	1+,1
Konstruksionet prej çeliku dhe alumini, bitumi dhe përzierjet bituminoze Adezivët për pllakat, materialet hidroizoluese	2+
Dyert dhe dritaret, Dritaret dhe dyert e jashtme për këmbësorët; tubat plastike për kullimin dhe kanalizimet, Guri natyror, produktet e betonit të parafabrikuar, pllakat, tullat etj.	3, 4
Produktet gjysmë të gatshme prej çeliku; fletët, tubat, shufrat dhe të ngjashme (jo të harmonizuara)	/

OVK-të në shtetet palë të CEFTA-s janë të akredituara kryesisht në përputhje me EN ISO/IEC 17025 për laboratorët e testimit dhe të kalibrimit, EN ISO/IEC 17065 për organet e certifikimit të produkteve, proceseve dhe shërbimeve, dhe EN ISO/IEC 17021 për organet e certifikimit të sistemeve të menaxhimit.

1.5 Standardet e harmonizuara

Standardet e harmonizuara hartohen nga organizatat evropiane të standardizimit CEN/CENELEC në bazë të kërkesave për standardizim nga Komisioni Evropian. Në vijim të një vlerësimi të brendshëm nga CEN/CENELEC, standardet miratohen dhe i paraqiten Komisionit për vlerësim dhe citim në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE). Ky citim shërben si referencë zyrtare për vlerësimin dhe deklaratën e performancës së karakteristikave themelore të mbuluara. Rrjedhimisht, prodhuesit i përdorin ato për të gjitha produktet e ndërtimit të mbuluara nga standardet e harmonizuara dhe i pajisin ato me markimin CE.

Specifikimet teknike të dhëna në një hEN përfshijnë kërkesat për testimin, llogaritjen dhe metodat e tjera të vlerësimit të vetive që lidhen me karakteristikat themelore të produkteve të ndërtimit, të cilave prodhuesit

duhet t'u përmbahen. Për karakteristikat individuale përcaktohen vlera specifike kufi, dhe vlerat e produktit duhet të mbeten konsistente.

Të gjitha produktet që mbulohen nga standardet e harmonizuara duhet të respektojnë kërkesat e këtyre të fundit dhe të ndjekin procedurat e parashikuara prej tyre, deri në etiketimin e produkteve me **markimin CE** dhe lëshimin e **një Deklarate Performance** për to. Format i markimit CE përcaktohet sipas standardit përkatës, ndërsa përkufizimi dhe përmbajtja e deklaratës së performancës përshkruhet në **Rregulloren e Deleguar (BE) nr. 574/2014**.

2. ROLI I STANDARDEVE NË PROJEKTIMIN E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT

2.1 Të përgjithshme

Standardet e harmonizuara luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit. Kur përdoren dhe zbatohen në mënyrë rigoroze gjatë procesit të projektimit, ndërtimit dhe vlerësimit të konformitetit të produkteve të ndërtimit, ato çojnë në prezumim të konformitetit me dispozitat e CPR-së.

Përdorimi i standardeve të harmonizuara luan një rol thelbësor në vlerësimin e performancës së produkteve të ndërtimit për sa u përket karakteristikave të tyre themelore, duke siguruar që prodhuesit të përdorin metodat dhe kriteret e parashikuara në këto standarde të harmonizuara për vlerësimin e produkteve të ndërtimit.

Standardet parashtrajnë praktikën profesionale më të mira, udhëzimet dhe parimet e projektimit që ndihmojnë në garantimin e cilësisë së produkteve të ndërtimit për përdorim në ndërtesa. Ato japin gjithashtu rekomandime lidhur me faktorë të tillë si kërkesat në lidhje me materialet dhe përbërjet, përmasat, tolerancat, rezistenca mekanike dhe kimike, kapaciteti mbajtës i ngarkesës, rezistenca ndaj erës dhe ujit, rezistenca ndaj zjarrit, izolimi termik dhe akustik, lloji i finiturës së sipërfaqes etj.

Organet e standardeve i përditësojnë dhe i rishikojnë vazhdimisht standardet për të përfshirë në to njohuritë e reja, përparimet dhe tendencat e industrisë, metodat e reja testimit dhe karakteristikat e reja, duke marrë kryesisht në konsideratë faktorët mjedisorë, sigurinë kimike dhe qëndrueshmërinë.

1.1 Struktura e standardit (hEN)

Standardet e harmonizuara me kërkesa specifike për produktet janë të strukturuar si më poshtë:

- **Tre kërkesat hyrës** përmbajnë objektin, japin dokumentet referencë dhe shpjegojnë termit dhe përkufizimet e përdorura nga standardi.
- **Kreu 4** përshkruan në mënyrë më të detajuar të gjitha kërkesat për produktin dhe performancën e nevojshme, të cilat janë me rëndësi për përmbushjen e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit për sa i përket shëndetit, sigurisë, përdorshmërisë, etj. Për çdo karakteristikë, përcaktohet një metodë testimi dhe përdorimi i pajisjeve matëse.
- **Kreu 5** paraqet kërkesat dhe rekomandimet për etiketimin dhe paketimin, si dhe paralajmërimet e rëndësishme individuale për konsumatorët.
- **Kreu 6** trajton më në detaje procedurën për vlerësimin e konformitetit dhe kryerjen e kontrollit të brendshëm të prodhimit.

Klauzolat e tjera të veçanta në shtojca (qoftë të natyrës normative dhe/ose informative) janë gjithashtu të rëndësishme për përmbushjen e kërkesave të CPR-së:

- **Shtojca A** përcakton marrjen e mostrave, metodat e marrjes së mostrave, markimin e mostrave, aparatat dhe skemën e raportimit mbi marrjen e mostrave.
- **Shtojca B** përcakton procedurat e kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe jep udhëzime për shpeshësinë e inspektimit
- **Shtojcat C, D, E...** për kërkesa ose udhëzime të tjera të veçanta, nëse ka të tilla
- **Shtojca ZA** (ose ZB, etj...) përmban dispozitat në lidhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, projektimin dhe përmbajtjen e markimit CE të parashikuar për çdo produkt, si dhe deklaratat e konformitetit.

Pajtuueshmëria me dispozitat e Shtojcës ZA çon në prezumim të konformitetit të produkteve dhe përshtatshmërisë së tyre për përdorimet e


synuara të specifikuara në Tabelën ZA.1 me objektin dhe klauzolat përkatëse në lidhje me karakteristikat themelore dhe mënyrën e nxjerrjes së rezultateve.

Shtojca ZA parashikon procedurat e vërtetimit të konformitetit dhe sistemin përkatës AVCP. Vlerësimi i konformitetit bazohet në procedurën e vlerësimit të konformitetit që rezulton nga klauzolat e cilësuar në tabelën e një standardi evropian. Në klauzolën e fundit të shtojcës ZA, paraqiten shembuj (figura) të markimit CE dhe informacione paralele mbi karakteristikat e produktit.

Komponentët e detyrueshëm të etiketës (deklaratës) janë:

- emri dhe adresa e regjistruar e prodhuesit ose përfaqësuesit të autorizuar që hedh produktin në treg,
- dy shifrat e fundit të vitit në të cilin produkti është hedhur në treg,
- referenca ndaj standardit të përdorur,
- përshkrimi (klasifikimi) i produktit dhe cilësimi i përdorimit fundor,
- informacioni mbi karakteristikat e mandatuara: përshkrimi dhe informacioni mbi produktin, duke përfshirë vlerat e deklaruara dhe rezultatet e arritura nga tabelat ZA. Përdorimi i standardeve të harmonizuara në sektorin e ndërtimit është i detyrueshëm të dëshmuar konformitetin e produkteve. Aty ku përdoren folje në kohën e tashme, kjo do të thotë se zbatimi është i detyrueshëm, ndërsa forma gjysmëndihmëse "duhet" nënkupton zbatimin fakultativ të një kërkesë. Gjithashtu, disa shtojca janë informative, ndërsa disa të tjera janë normative.

Organi i standardizimit që është anëtar i plotë i CEN/CENELEC është i detyruar të transpozojë standardet e harmonizuara në listën e standardeve vendase pa asnjë modifikim, përveç rasteve kur për disa materiale ekzistojnë kriteret kombëtare në një shtojcë kombëtare për disa performanca ose kriteret kombëtare të produkteve (si p.sh. për betonin). Në krerët e mëtejshëm do të prezantohen procedurat që janë të detyrueshme për prodhuesit.



3. VLERËSIMI I KONFORMITETIT NË KUADËR TË CPR-SË

3.1 Të përgjithshme

Prodhuesi do të kryejë procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve të ndërtimit me hEN-të. Për disa produkte ndërtimi, vlerësimi i konformitetit mund të kryhet nga vetë prodhuesi.

Prodhuesi zbaton dhe kryen kontrollin e prodhimit në fabrikë për çdo produkt dhe të gjitha AVCP-të, ndërsa për AVCP 1, 1+ dhe 2+, produktet do të certifikohen gjithashtu nga një organ i notifikuar (shih Tabelën 1).

AVCP	ORGANI I NOTIFIKUAR I CERTIFIKIMIT TË PRODUKTIT	PRODHUESIT kryejnë
1	(i) një vlerësim të performancës së produktit të ndërtimit të kryer në bazë të testimit (duke përfshirë marrjen e mostrave), llogaritjes, vlerave të paraqitura në formë tabelash ose dokumentacionit përshkrues të produktit; (ii) inspektimin fillestar të impiantit të prodhimit dhe të kontrollit të prodhimit në fabrikë; (iii) mbikëqyrjen dhe vlerësimin e vazhdueshëm të kontrollit të prodhimit në fabrikë; plus	(i) kontrollin e prodhimit në fabrikë; (ii) testimin e mëtejshëm të mostrave të marra në impiantin e prodhimit nga prodhuesi në përputhje me planin e paracaktuar të testimit.
1+	(iv) testimin auditues të mostrave të marra nga organi i notifikuar i certifikimit të produktit në impiantin e prodhimit ose në ambientet e magazinimit të prodhuesit.	plus
2+	(i) inspektimin fillestar të impiantit të prodhimit dhe të kontrollit të prodhimit në fabrikë; (ii) mbikëqyrjen dhe vlerësimin e vazhdueshëm të kontrollit të prodhimit në fabrikë.	(iii) një vlerësim të performancës së produktit të ndërtimit të kryer në bazë të testimit (duke përfshirë marrjen e mostrave), llogaritjes, vlerave të paraqitura në formë tabelash ose dokumentacionit përshkrues të atij produkti;
3	Vlerësimin e performancës në bazë të testimit (bazuar në marrjen e mostrave nga prodhuesi), llogaritjes, vlerave të paraqitura në formë tabelash ose dokumentacionit përshkrues të produktit të ndërtimit.	(i) kontrollin e prodhimit në fabrikë
4	Asnjë detyrë	(i) një vlerësim të performancës së produktit të ndërtimit të kryer në bazë të testimit, llogaritjes, vlerave të paraqitura në formë tabelash ose dokumentacionit përshkrues të atij produkti; (ii) kontrollin e prodhimit në fabrikë.

Tabela 1: Ndarja e detyrave të vlerësimit të konformitetit për prodhuesin dhe organin e notifikuar sipas sistemeve AVCP

3.2 Procedura e vlerësimit të brendshëm të konformitetit

Mundësuesit kryesorë për kryerjen e vlerësimit të konformitetit në nivel të brendshëm nga prodhuesi, veçanërisht për produktet e mbuluara nga AVCP 3 dhe 4, janë:

- kompetencat e personelit përgjegjës (njohuritë dhe përvoja teknike),
- pajisjet e testimit dhe pajisjet matëse (mund të përfshijnë stendat ose strukturat e provës, pajisjet matëse),
- pajisjet dhe procedurat e prodhimit. Procedurat duhet të trajtojnë aspekte të tilla si testimi fillestar i tipit, kontrolli i prodhimit në fabrikë dhe certifikimi i tij (sipas AVCP 1, 1+ dhe 2+) dhe vërtetimi i konformitetit të produktit të përfunduar.

Megjithatë, rezultatet e proceseve të vlerësimit të konformitetit duhet të jenë plotësisht të gjurmueshme dhe të përsëritshme. Thënë kjo, prodhuesi duhet të mundësojë kontrollin e vet të brendshëm të prodhimit në fabrikë, duke përfshirë një sistem menaxhimi që siguron që rezultatet e vlerësimit të konformitetit të mund të riprodhohen gjatë kontrolleve të mbikëqyrjes së tregut.

Ky sistem menaxhimi (për cilësinë) nuk ka nevojë të jetë i certifikuar, por në ndërmarrjet e mesme këshillohet që ai të ndjekë kërkesat e standardit ISO 9001 për të garantuar përmbushjen e objektivave të mësipërme. Në veçanti, tregohet një kujdes i veçantë për përmbushjen e kërkesave në lidhje me validimin e projektimit (klauzola 8.3.3, ISO 9001) dhe validimin e prodhimit (klauzola 8.5.3, ISO 9001). Këtu përfshihet zbatimi i kontrolleve dhe verifikimeve në faza të ndryshme të prodhimit për të vërtetuar pajtueshmërinë me standardet dhe specifikimet e zbatueshme. Të dhënat që dëshmojnë pajtueshmërinë me hEN-të do të ruhen për 10 vite.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme që prodhuesi të përditësohet me zhvillimet më të fundit të legjislacionit dhe standardeve. Niveli drejtues duhet të jetë i vetëdijshëm se ai është drejtpërdrejt përgjegjës për konformitetin e produkteve.

Në ndërmarrjet mikro, sipas përkufizimit në nenin 2 të Rekomandimit të Komisionit (2003/361/KE)⁴, mund të përdoren disa procedura të thjeshtuara, të cilat shpjegohen më tej në kreun 5.3.

4. Testimi fillestar i tipit

Kur zhvillohet një tip i ri produkti, përpara se ai të nxirret në shitje ose të përdoret në punime ndërtimi, kryhen testet e duhura fillestare të tipit për të konfirmuar se vetitë e arritura të produktit janë në përputhje me kërkesat e hEN-ve dhe me vlerat e deklaruara për të nga prodhuesi.

Testet e tipit janë testet referencë të përmendura në hEN për vetitë e përzgjedhura nga lista e mëposhtme në përputhje me deklaratën e prodhuesit për përdorimin e synuar të tipeve të produktit, për shembull:

- Përmasat dhe tolerancat, konfigurimi,
- Dendësia e dukshme,
- Rezistenca e përgjithshme,
- Rezistenca në përkulje,
- Poroziteti i hapur,
- Koeficienti i përthithjes së ujit nga kapilariteti,

- Rezistenca ndaj ngrirjes/shkrirjes,
- Vetitë termike,
- Reagimi ndaj zjarrit,
- Përshkueshmëria nga avujt e ujit.

Para testimit, do të bëhet marrja e mostrave për testimin fillestar të tipit në përputhje me shtojcën A të standardit dhe numri i njësive që do të testohen është ai i dhënë në tabelë. Rezultatet e testimit fillestar të tipit regjistrohen.

Testit fillestar i tipit përsëritet në rastet kur ndodh një ndryshim i madh në lëndët e para ose në proporcionet e përdorura apo në procesin e prodhimit, i cili do të ndryshonte vetitë e produktit përfundimtar.

4.1 Pajisjet e testimit për vlerësimin e pajtueshmërisë

Kur bëhet fjalë për pajisjet e testimit për konformitetin e produkteve të ndërtimit, nevoja për pajisje testimi varet nga natyra e produkteve të ndërtimit. Megjithatë, ka disa fusha kryesore që merren më së shumti në konsideratë.

Metodat më të shpeshta të testimit kanë të bëjnë me performancën mekanike, fizike, kimike, mjedisore dhe atë në kushte rrezikshmërie, të cilat renditen në standardet e harmonizuara:

01. Performanca mekanike:

- **Rezistenca në këputje:** Mat ngarkesën maksimale që mund të përballojë një material pa u thyer.
- **Rezistenca në shtypje:** Vlerëson aftësinë e një materiali për t'u bërë ballë forcave shtypëse.
- **Rezistenca në përkulje:** Vlerëson rezistencën ndaj përkuljes.
- **Rezistenca ndaj goditjeve:** Përcakton rezistencën e një materiali ndaj goditjeve të papritura.
- **Fortësia:** Mat rezistencën e një materiali ndaj çjerrjeve ose gërvishetjeve.

02. Performanca fizike:

- **Qëndrueshmëria:** Vlerëson aftësinë e një produkti për t'u bërë ballë kushteve mjedisore (p.sh. motit, ekspozimit ndaj rrezeve UV, vjetërimit).
- **Përthithja e ujit:** Mat sesa ujë përthith një material.
- **Përçueshmëria termike:** Vlerëson sa mirë e përçon nxehtësinë një material.
- **Izolimi akustik:** Vlerëson aftësinë e një produkti për të reduktuar transmetimin e zërit.

03. Performancat kimike:

- **Rezistenca kimike:** Përcakton mënyrën se si një material reagon në rast ekspozimi ndaj kimikateve të ndryshme (acideve, alkaleve, tretësve).
- **Rezistenca ndaj korrozionit:** Vlerëson rezistencën e një produkti ndaj korrozionit (p.sh. në strukturat metalike).

04. Performanca në kushte rrezikshmërie:

- **Kapaciteti mbajtës i ngarkesës:** Vlerëson aftësinë e një strukture për të përballuar ngarkesat në mënyrë të sigurt.
- **Rezistenca ndaj rrëshqitjes:** Përcakton se sa e rrëshqitshme është një sipërfaqe (e rëndësishme për materialet e dysHEMEVE).
- **Rezistenca ndaj zjarrit:** Mat aftësinë e një materiali për t'i bërë ballë zjarrit dhe për të parandaluar përhapjen e tij.
- **Siguria elektrike:** kur në produktet e ndërtimit integrohen produkte elektrike, këto të fundit duhet të jenë të përshtatshme për produktet e ndërtimit sipas standardeve përkatëse të sigurisë të parashikuara në rregulloret e tjera.
- **Toksiciteti:** Vlerëson dëmin e mundshëm nga substancat toksike (p.sh. plumbi, metalet e rënda, asbesti).

05. Performanca mjedisore – Gjurma e karbonit dhe cikli i jetës:

- Rregulloret e reja, siç është rregullorja mjedisore e vitit 2020 (RE2020), theksojnë studimin e **gjurmës së karbonit** të ndërtesave gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës.
- Kjo përfshin vlerësimin e ndikimit të produkteve të ndërtimit të përdorura në ndërtesë.

Këto teste udhëhiqen nga standarde dhe rregullore specifike, të cilat sigurojnë që produktet e ndërtimit të përmbushin kërkesat e sigurisë dhe të performancës. Të kuptuarit e performancës mjedisore të produkteve të ndërtimit dhe integrimi i pajisjeve teknike të ndërtimit në vlerësime siguron ndërtesa më të qëndrueshme dhe ekologjike dhe performanca afatgjata (ndërtesa me jetëgjatësi).

Testimi kryhet ose nga prodhuesi (rallëherë), ose nga një organ i notifikuar me të cilin prodhuesi bashkëpunon.

5. Kontrolli i prodhimit në fabrikë

5.1 Të përgjithshme

Prodhuesi krijon, dokumenton dhe ruan një sistem të kontrollit të prodhimit në fabrikë për të mundësuar konformitetin e vazhdueshëm me hEN dhe me vlerat e deklaruara të produkteve të hedhura në treg.

Sipas rastit, përgjegjësia, autoriteti dhe ndërveprimi i të gjithë personelit që menaxhon, kryen dhe verifikon punën që ndikon në cilësinë e njësive të prodhimit përcaktohet në dokumentacionin e Kontrollit të Prodhimit në Fabrikë (KPF).

Sistemi i KPF-së përshkruan procedurën e prodhimit, inspektimet e rregullta nga

prodhuesi dhe testimin e kryer prej tij. Kontrollat dhe testet duhet të përfshijnë karakteristikat e produkteve, procesin e prodhimit, pajisjet e prodhimit ose makineritë e prodhimit, pajisjet e testimit ose instrumentet e testimit dhe markimin e produktit.

Rezultatet e testeve që kërkojnë marrje masash dhe rezultatet e testimit do të regjistrohen. Masat që duhet të merren kur vlerat ose kriteret e testit të kontrollit nuk përmbushin ato të specifikuara duhet të dokumentohen nga prodhuesi.

5.2 Manuali i kontrollit të prodhimit në fabrikë

Qëllimi i manualit të kontrollit të prodhimit në fabrikë është të dëshmojë pajtueshmërinë e produktit apo të prototipit të produktit në seri me kërkesat e rregulloreve të zbatueshme. Ai përmban informacionin e nevojshëm mbi projektimin, ndërtimin dhe vlerësimin e konformitetit të produktit. Prandaj, është më se e qartë se i vetmi person përgjegjës për përgatitjen e saj mund të jetë prodhuesi.

Prodhuesi krijon, dokumenton dhe ruan një sistem të kontrollit të prodhimit në fabrikë për të mundësuar konformitetin e vazhdueshëm me standardin e produktit dhe me vlerat e deklaruara të produktit të hedhur në treg.

Sipas rastit, përgjegjësia, autoriteti dhe ndërveprimi i të gjithë personelit që menaxhon, kryen dhe verifikon punën që ndikon në cilësinë e një produkti përcaktohet në dokumentacionin e KPF-së. Për shembull,

përmbajtja e manualit të KPF-së mund të jetë si më poshtë:

1. Hyrje

2. Organizimi

2.1. Përgjegjësia dhe autoriteti

2.2. Përfaqësuesi i nivelit drejtues

2.3. Shqyrtimi nga niveli drejtues

3. Procedurat e kontrollit

3.1. Manuali i kontrollit

3.2. Kontrolli i dokumenteve dhe të dhënave

3.3. Shërbimet e nënkontraktuara

3.4. Lëndët e para

4. Menaxhimi i prodhimit

4.1. Procesi i prodhimit

4.2. Trajnimi i personelit

5. Inspektimi dhe testimi

5.1. Të përgjithshme

5.2. Pajisjet

5.3. Marrja e mostrave (shpeshësia, vendndodhjet)

5.4. Testimi i produktit të përfunduar

6. Të dhënat

7. Kontrolli i produktit jokonform

8. Trajtimi, magazinimi dhe ruajtja në

kushtet e duhura

Trajtimi

Veçimi

Pastërtia e pajisjeve të trajtimit dhe zonave të magazinimit

9. Transporti dhe paketimi

9.1. Transporti

9.2. Paketimi

10. Markimi dhe dokumentacioni

5.2.1 Të përgjithshme

Duhet të përcaktohet, kryhet dhe dokumentohet procedura e kontrollit të prodhimit në instalimin e prodhimit. Të gjitha procedurat, kërkesat dhe masat e kontrollit duhet të dokumentohen sistematikisht në një **“manual të kontrollit të prodhimit në fabrikë”** dhe të gjitha rezultatet e matjeve të kontrollit të brendshëm duhet të dokumentohen sipas kërkesave të standardit.

Sistemi i kontrollit të prodhimit në fabrikë përshkruan procedurën e prodhimit, inspektimet e rregullta nga prodhuesi dhe testimin e kryer prej tij. Kontrollat duhet të përfshijnë karakteristikat e produkteve, procesin e prodhimit, pajisjet e prodhimit ose makineritë e prodhimit, pajisjet e testimit ose instrumentet e testimit dhe procesin e markimit të produktit. Rezultatet e testeve që kërkojnë marrje masash regjistrohen. Masat që duhet të merren kur vlerat ose kriteret e testeve të kontrollit nuk përmbushin ato të specifikuar duhet të dokumentohen nga prodhuesi.

5.2.2 Pajisjet e testimit dhe pajisjet matëse

Të gjitha pajisjet përkatëse matëse dhe ato të testimit që kanë ndikim te vlerat e deklaruara kalibrohen dhe inspektohen rregullisht sipas procedurave të dokumentuara, intervaleve të paracaktuara dhe sipas përcaktimit në manualin e KPF-së.

5.2.3 Pajisjet e prodhimit

Të gjitha pajisjet e prodhimit që kanë ndikim te vlerat e deklaruara kontrollohen dhe inspektohen rregullisht sipas udhëzimeve në shtojcën B të standardeve të harmonizuara.

5.2.4 Lëndët e para

Sipas rastit, dokumentohen të gjitha specifikimet për materialet hyrëse dhe procedurat që duhet të kryhen për të siguruar pajtueshmërinë e tyre. Udhëzimet për inspektimin e lëndëve të para jepen në Shtojcën B të standardeve të harmonizuara.

5.2.5 Procesi i prodhimit

Veçoritë përkatëse të procesit të prodhimit, duke përfshirë shpeshhtësinë e kontrolleve të inspektimit nga prodhuesi dhe kriteret e nevojshme, përcaktohen sipas udhëzimeve në shtojcën B. Masat që duhet të merren kur kriteret nuk arrihen specifikohen gjithashtu nga prodhuesit.

5.2.6 Testimi i produkteve të përfunduara

Sistemi i KPF-së përfshin një plan të marrjes së mostrave dhe shpeshhtësinë e testimit të produkteve të përfunduara. Rezultatet e marrjes së mostrave dhe testimit regjistrohen. Mostrat janë të tilla që përfaqësojnë siç duhet produktin. Prodhuesit mund të përcaktojnë kriterin e konformitetit për vlerësimin e prodhimit.

5.2.7 Markimi dhe kontrolli i stokut të produkteve

Markimi dhe kontrolli i stokut dokumentohen. Lotet e produkteve duhet të jenë të identifikueshme dhe të gjurmueshme. Udhëzimet për skemën e inspektimit jepen në Shtojcën B të standardit të harmonizuar.

5.2.8 Produktet jokonforme

Procedura për trajtimin e produkteve jokonforme dokumentohet. Produktet që nuk janë në konformitet me kërkesat duhet të veçohen dhe të markohen përkatësisht. Prodhuesit marrin masa për të shmangur përsëritjen e jokonformitetit.

5.3 Procedurat e thjeshtuara nga ndërmarrjet mikro

Në Kreun VI [nenet 36, 37 dhe 38] të CPR-së, jepen disa procedura të thjeshtuara që mund të përdoren vetëm nga ndërmarrjet mikro në vlerësimin e konformitetit⁵:

5.3.1 Përdorimi i dokumentacionit teknik të përshtatshëm - Neni 36

01. Në përcaktimin e tipit të produktit, prodhuesi mund të zëvendësojë testimin e tipit ose llogaritjen e tipit me dokumentacionin teknik të përshtatshëm që tregon se:

a. për një ose disa karakteristika themelore të produktit të ndërtimit që prodhuesi hedh në treg, ai **produkt konsiderohet se arrin një nivel ose kategori të caktuar performance pa testim ose llogaritje**, ose pa testime ose llogaritje të mëtejshme, në

përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike të harmonizuara përkatëse ose në një vendim të Komisionit;

b. **REZULTATET E PËRBASHKËTA TË TFT-SË:** produkti i ndërtimit i mbuluar nga një standard i harmonizuar, të cilin prodhuesi e hedh në treg, përkon me tipin e produktit të një produkti tjetër ndërtimi, të prodhuar nga një prodhues tjetër dhe të testuar tashmë në përputhje me standardin e

harmonizuar përkatës. Kur plotësohen këto kushte, prodhuesi ka të drejtë të deklarojë një performancë që përkon me të gjitha ose me një pjesë të rezultateve të testimit të atij produkti tjetër. **Prodhuesi mund të përdorë rezultatet e testimit të përfuara nga një prodhues tjetër** vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e këtij të fundit, i cili mbetet përgjegjës për saktësinë, besueshmërinë dhe stabilitetin e këtyre rezultateve të testimit; ose

C. **REZULTATET E TRANSFERUARA TË TFT-SË:** kur **produkti i ndërtimit është një sistem i përbërë nga komponentë** të cilët prodhuesi i monton duke ndjekur në mënyrë precize udhëzimet e dhëna nga ofruesi i këtij sistemi apo i një komponenti të tij, i cili e ka **testuar tashmë atë sistem ose atë komponent për një ose disa nga karakteristikat e tij themelore** në përputhje me specifikimet teknike të harmonizuara përkatëse. Kur plotësohen këto kushte, prodhuesi ka të drejtë të deklarojë një performancë që përkon me të gjitha ose me një pjesë të rezultateve të testimit për sistemin ose produktin në fjalë. Prodhuesi mund **të përdorë**

rezultatet e testimit të përfuara nga një prodhues tjetër ose nga një ofrues tjetër i sistemit vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e këtij të fundit, i cili mbetet përgjegjës për saktësinë, besueshmërinë dhe stabilitetin e këtyre rezultateve të testimit.

02. Nëse produkti i ndërtimit i përmendur në paragrafin 1 i përket një familjeje produktesh ndërtimi për të cilën sistemi i zbatueshëm për vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës është sistemi 1 + ose 1, siç përcaktohet në shtojcën V, **dokumentacioni teknik i përshtatshëm i përmendur në paragrafin 1 verifikohet nga një organ i notifikuar i certifikimit të produkteve**, siç përmendet në shtojcën V.

5.3.2 Përdorimi i procedurave të thjeshtuara nga ndërmarrjet mikro - Neni 37

01. Ndërmarrjet mikro që prodhojnë produkte ndërtimi të mbuluara nga një standard i harmonizuar **mund ta zëvendësojnë përcaktimin e tipit të produktit në bazë të testimit të tipit** për sistemet e zbatueshme 3 dhe 4, siç përcaktohet në shtojcën V, **duke përdorur metoda të ndryshme** nga ato që përmban standardi i harmonizuar përkatës. Këta prodhues mund të trajtojnë gjithashtu produkte ndërtimi për të cilat zbatohet sistemi 3 në përputhje me parashikimet për sistemin 4.

02. Kur një prodhues përdor këto procedura të thjeshtuara, prodhuesi dëshmon pajtueshmërinë e produktit të ndërtimit me kërkesat e zbatueshme me anë të **një dokumentacioni teknik specifik** dhe dëshmon barasvlershmërinë e procedurave të përdorura me procedurat e parashikuara në standardet e harmonizuara.

5.3.3 Procedura të tjera të thjeshtuara - Neni 38

- 01.** Për sa u përket produkteve të ndërtimit të mbuluara nga një standard i harmonizuar dhe **që janë prodhuar individualisht ose janë personalizuar në kuadër të një procesi jo në seri**, bazuar në një porosi specifike, dhe që janë instaluar në një punim të vetëm të identifikuar ndërtimi, vlerësimi i performancës i kërkuar në bazë të sistemit të zbatueshëm mund të zëvendësohet nga prodhuesi me **dokumentacionin teknik specifik** që dëshmon pajtueshmërinë e atij produkti me kërkesat e zbatueshme dhe barasvlershmërinë e procedurave të përdorura me procedurat e përcaktuara në standardet e harmonizuara.
- 02.** Nëse produkti i ndërtimit i përmendur në paragrafin 1 i përket një familjeje produktesh ndërtimi për të cilën **sistemi i zbatueshëm për vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës është sistemi 1 + ose 1**, siç përcaktohet në shtojcën V, **dokumentacioni teknik specifik verifikohet nga një organ i notifikuar i certifikimit të produkteve**, siç përmendet në shtojcën V.

6. DEKLARATA E PERFORMANCËS DHE MARKIMI CE

Kur arrihet pajtueshmëria me kushtet e shtojcës ZA të hEN, dhe pasi një organ i notifikuar ka hartuar dhe lëshuar certifikatën e KPF-së, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i vendosur në ZEE përgatit dhe ruan një deklaratë performance, e cila i jep prodhuesit të drejtën të vendosë markimin CE.

6.1 Deklarata e performancës CE

Deklarata e Performancës është një pjesë kyç e Rregullores për Produktet e Ndërtimit. Ajo jep informacione mbi performancën e një produkti. Çdo produkt ndërtimi i mbuluar nga një standard i harmonizuar evropian ose për të cilin është lëshuar një vlerësim teknik evropian ka nevojë për një deklaratë të tillë dhe duhet të mbartë markimin CE. Kjo ndihmon në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e funksionimit të Tregut të Brendshëm.

Mundësuesit kryesorë për kryerjen e vlerësimit të konformitetit në nivel të brendshëm nga prodhuesi, veçanërisht për produktet e mbuluara nga AVCP 3 dhe 4, janë:

- kompetencat e personelit përgjegjës (njohuritë dhe përvoja teknike),
- pajisjet e testimit dhe pajisjet matëse (mund të përfshijnë stendat ose strukturat e provës, pajisjet matëse),
- pajisjet dhe procedurat e prodhimit. Procedurat duhet të trajtojnë aspekte të tilla si testimi fillestar i tipit, kontrolli i prodhimit në fabrikë dhe certifikimi i tij (sipas AVCP 1, 1+ dhe 2+) dhe vërtetimi i konformitetit të produktit të përfunduar.

Deklarata përfshin të gjithë informacionin e dhënë në Rregulloren e Deleguar (574/2014/BE) për modelin që duhet përdorur për hartimin e një deklaratë performance për produktet e ndërtimit.

DEKLARATA E PERFORMANCËS

Nr.

1. Kodi unik i identifikimit të tipit të produktit:

2. Përdorimet e synuara:

3. Prodhuesi:

4. Përfaqësuesi i autorizuar:

5. Sistemet e AVCP-së:

6a. Standardi i harmonizuar:.....

Organet e notifikuara:

6b. Dokumenti evropian i vlerësimit:

Vlerësimi teknik evropian:

Organi i vlerësimit teknik:

Organet e notifikuara:

7. Performancat e deklaruara:

8. Dokumentacioni teknik i përshtatshëm dhe/ose dokumentacioni teknik specifik:

Performanca e produktit të identifikuar më sipër është në përputhje me grupin e performancave të deklaruara. Bazuar në sa më lart, lëshohet kjo deklaratë e performancës në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 305/2011, nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit të identifikuar më sipër.

Nënshkruar për dhe në emër të prodhuesit nga:

[emri]

në (vendi) më [data e lëshimit]

[nënshkrimi]

Figura 4: Modeli i deklaratës së performancës nga Rregullorja e deleguar 574/2014/BE

Përrjashtimet nga hartimi i një deklarate performance – neni 5⁶

Prodhuesi mund të mos hartojë një deklaratë performance kur hedh në treg një produkt ndërtimi që mbulohet nga një standard i harmonizuar, në rastet kur:

- a. produkti i ndërtimit **është prodhuar individualisht ose është personalizuar në kuadër të një procesi jo në seri**, bazuar në një porosi specifike, dhe është instaluar në një punim të vetëm të identifikuar ndërtimi, nga një prodhues i cili është përgjegjës për integrimin e sigurt të produktit në punimet e ndërtimit, në përputhje me rregullat e zbatueshme kombëtare dhe nën përgjegjësinë e personave përgjegjës për realizimin e sigurt të punimeve të ndërtimit të përcaktuara sipas rregullave të zbatueshme kombëtare;
- b. produkti i ndërtimit **është prodhuar në sheshin e ndërtimit** për integrimin e tij në punimet përkatëse të ndërtimit, në përputhje rregullat e zbatueshme kombëtare dhe nën përgjegjësinë e personave përgjegjës për realizimin e sigurt të punimeve të ndërtimit të përcaktuara sipas rregullave të zbatueshme kombëtare; ose
- c. produkti i ndërtimit është prodhuar **në mënyrë tradicionale ose në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen e trashëgimisë** dhe në kuadër të një procesi joindustrial për rinovimin e duhur të punimeve të ndërtimit të mbrojtura zyrtarisht si pjesë e një mjedisi të caktuar ose për shkak të meritës së tyre të veçantë arkitekturore ose historike, në përputhje me rregullat e zbatueshme kombëtare.

6.2 Markimi CE për produktet e ndërtimit

Markimi CE tregon se një produkt ndërtimi është në përputhje me performancën e tij të deklaruar dhe se ai është vlerësuar sipas një **standardi të harmonizuar evropian** ose për të është lëshuar një **vlerësim teknik evropian**.

Prodhuesi ose agjenti i tij i vendosur në ZEE është përgjegjës për vendosjen e markimit CE. Simboli i markimit CE që vendoset u nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 30 të Rregullores (KE) nr. 765/2008 dhe vendoset mbi një produkt ose, kur kjo nuk është e mundur, mbi etiketën shoqëruese, mbi paketim ose në dokumentet tregtare shoqëruese, siç është fletëdërgesa.

Simboli i markimit CE shoqërohet me informacionin e mëposhtëm:

- numrin e identifikimit të organit të certifikimit (vetëm për produktet që mbulohen nga sistemi 2+, 1 dhe 1+);
- emrin ose shenjën identifikuese dhe adresën e regjistruar të prodhuesit,
- dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur markimi;
- numrin e certifikatës EC të konformitetit të certifikatës së KPF-së (sipas rastit);
- referencën ndaj hEN-së së përdorur;
- përshkrimin e emrit gjenerik, materialit, përmasave... dhe përdorimit të synuar të produktit;
- informacionin mbi karakteristikat themelore përkatëse të listuara në Tabelën ZA.1:

- vlerat e deklaruara dhe, sipas rastit, niveli ose kategoria e deklaruar për secilën karakteristikë (siç cilësohet në Shënimet e Tabelës ZA.1;
- Në të kundërt, përcaktimin e standardeve, qoftë vetëm apo së bashku me vlerat e deklaruara, si dhe
- deklarin NPD “No performance determined” (performancë e papërcaktuar) për karakteristikat për të cilat kjo është e vlefshme.

Opsioni NPD (performancë e papërcaktuar) nuk mund të përdoret në rastet kur karakteristika i nënshtrohet një niveli kufi. Ndërkohë, opsioni NPD mund të përdoret kur karakteristika përkatëse, për një përdorim të synuar të caktuar, nuk u nënshtrohet kërkesave rregullore në shtetin anëtar të destinacionit apo për qëllimin e synuar të produktit.

Figurat specifike të markimeve CE dhe shembujt e informacionit të markimit CE jepen në fund të shtojcës ZA të standardeve të harmonizuara.

7. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT PËR PRODUKTET JO TË HARMONIZUARA

Siç u pa në kërret e mësipërm, CPA-ja dallon nga aktet e kuadrit të ri legjislativ të BE-së, pasi ajo thjesht harmonizon metodat e vlerësimit për performancën e produkteve të ndërtimit, pa përcaktuar kërkesat që zbatohen në mbarë BE-në për këto produkte. Në vend të kësaj, ajo vendos rregulla të harmonizuara mbi mënyrën sesi duhet shprehur performanca e tyre në lidhje me karakteristikat e tyre themelore, si dhe rregullat mbi markimin e tyre CE.

Kjo gjithë e përbashkët teknike konsiston në specifikime teknike të harmonizuara:

- **standardet e harmonizuara** të hartuara nga organet evropiane të standardizimit (CEN-CENELEC) bazuar në kërkesat për standardizim (“mandatet”) të lëshuara nga Komisioni dhe
- dokumentet evropiane të vlerësimit (EAD-të), të cilat përbëjnë **alternativën në mungesë të standardeve të harmonizuara dhe zbatohen për produktet e ndërtimit që nuk mbulojnë nga këto standarde.**

Në praktikë, nëse një prodhues **produkti i ndërtimit të të cilit nuk mbulohet nga një standard i harmonizuar dëshiron që produkti i tij të pajiset me markimin CE**, ai duhet të kërkojë një vlerësim teknik evropian (ETA) nga një organ i vlerësimit teknik (TAB). Markimi CE e lejon prodhuesin që ta tregtojë lirisht produktin e tij në të gjithë Zonën Ekonomike Evropiane, si dhe në Zvicër dhe Turqi.

Vlerësimi teknik evropian lëshohet më pas mbi bazën e specifikimeve teknike të harmonizuara të përfshira në një **dokument vlerësimi evropian (EAD)**. EAD-ja hartohet zakonisht kur një prodhues kërkon një Vlerësim Teknik Evropian (ETA) dhe nuk ekzistojnë kritere të harmonizuara për vlerësimin e performancës së produktit.

Organizata Evropiane për Vlerësimin Teknik (EOTA) – shoqata mbarëevropiane e organeve të vlerësimit teknik (TAB-ve) për produktet e ndërtimit, e themeluar në kuadër të CPR-së – koordinon punën dhe miraton dokumentin evropian të vlerësimit.

Vlerësimi teknik evropian i lejon prodhuesit të produktit përkatës të ndërtimit që të hartojë një deklaratë performance (DP) për këtë produkt. I gjithë procesi njihet gjithashtu si “*rruga e EOTA-s*”.

Komisioni publikon listën e referencave të dokumenteve evropiane përfundimtare të vlerësimit *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*. Sipas rastit, pas konsultimit me Komitetin e Përhershëm për Ndërtimin, Komisioni merr për bazë dokumentet evropiane ekzistuese të vlerësimit për mandatet që do të lëshohen dhe një listë referencash të dokumenteve evropiane

përfundimtare të vlerësimit, e cila publikohet në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*. Komisioni publikon çdo përditësim të kësaj liste.

SHËNIM: Nga momenti i hyrjes në fuqi të CPR-së e deri në fund të vitit 2021, EOTA ka hartuar 583 EAD, mbi bazën e të cilave organet e vlerësimit teknik të EOTA-s kanë lëshuar 10 519 vlerësime teknike evropiane.

7.1 Faktet lidhur me procedurën (rrugën) e ETA-s

Vlerësimi Teknik Evropian (ETA) siguron një procedurë të pavarur mbarëevropiane për vlerësimin e karakteristikave themelore të performancës së produkteve jo të harmonizuara të ndërtimit.

ETA u ofron prodhuesve një **rrugë vullnetare drejt markimit CE**, kur produkti nuk mbulohet ose nuk mbulohet plotësisht nga një standard i harmonizuar (hEN) sipas Rregullores për Produktet e Ndërtimit (BE) 305/2011.

Procedura e ETA-s është e hapur për prodhuesit e produkteve të ndërtimit në të gjitha llojet e produkteve, pavarësisht faktit nëse apo mënyrës sesi produktet janë të rregulluara në nivel kombëtar. Prodhuesit mund të paraqesin një kërkesë për ETA pranë çdo organi të vlerësimit teknik (TAB) të caktuar për llojin e produktit në fjalë nga një shtet anëtar i BE-së. TAB do ta udhëzojë

prodhuesin në çdo hap të procedurës, në cilësinë e TAB-së përgjegjëse (RTAB).

ETA do të bazohet në një Dokument Evropian Vlerësimi (EAD), i cili është një specifikim teknik i harmonizuar i hartuar nga EOTA si bazë për ETA-n. Nëse produkti në fjalë nuk është ende (plotësisht) i mbuluar nga një EAD ekzistuese, EOTA do të hartojë një dokument të ri evropian vlerësimi apo do të përshtatë një dokument ekzistues.

Prodhuesit mund të përdorin rrugën vullnetare të ETA-s për të markuar produktin e tyre nëse ai nuk mbulohet plotësisht nga një standard i harmonizuar (hEN) ekzistues, apo edhe në rastin kur është lëshuar një mandat për një standard të harmonizuar, por kjo është e mundur vetëm deri në momentin kur fillon periudha e bashkekzistencës sipas përcaktimit nga Komisioni.

7.2 Procedura e lëshimit të vlerësimit teknik evropian

Aplikimi për një ETA është mjaft i thjeshtë. Zgjidhni një **organ të vlerësimit teknik (TAB) si partner për lëshimin e një ETA-je**. TAB-ja do të fillojë më pas një proces me 5 hapa për ju (shihni më poshtë).

Vlerësimi teknik evropian lëshohet nga një TAB me kërkesë të një prodhuesi, mbi bazën e një dokumenti evropian të vlerësimit të hartuar në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 21 dhe në shtojcën II të CPR-së. Në figurën 5 paraqitet një diagram i thjeshtë që ilustron procedurën për lëshimin e një ETA-je.




Figura 5: Procedura e lëshimit të një ETA-je

Pesë hapat e procedurës janë si vijon:

01. Aplikimi

Prodhuesi kërkon një ETA nga një TAB e caktuar për llojin përkatës të produktit.

TAB-ja i jep prodhuesit një formular kërkesë për ETA-n, i cili duhet plotësuar me:

- llojin dhe përshkrimin e produktit të ndërtimit

- karakteristikat e tij themelore dhe përdorimin e synuar
- cilësimin nëse produkti i ndërtimit nuk mbulohet ose nuk mbulohet plotësisht nga një standard i harmonizuar ose një EAD
- deklaratën se një nuk është paraqitur asnjë kërkesë e mëparshme përpara një TAB-je tjetër.

02. Kontrata e shërbimit

TAB-ja kontrollon formularin e kërkesës dhe i jep kërkuarit kushtet e tij të përgjithshme dhe një kuotim. Të dyja palët **nënshkruajnë një kontratë shërbimi** që përfshin një marrëveshje për konfidencialitetin dhe ruajtjen e sekretit tregtar. Në rastet kur produkti nuk mbulohet ose nuk mbulohet plotësisht nga një EAD ekzistuese, TAB-ja do të fillojë paralelisht hartimin e një EAD-je brenda EOTA-s.

03. Dosja teknike e prodhuesit (MTF)

Prodhuesi i jep TAB-së një **dosje teknike gjithëpërfshirëse të produktit të ndërtimit** për vlerësim. MTF-ja mbulohet nga marrëveshja për konfidencialitetin dhe ruajtjen e sekretit tregtar.

Shënim: Veçanërisht në rastin e risive dhe zhvillimeve të mëtejshme të produkteve, ne ju rekomandojmë që të flisni me TAB-në tuaj përpara se të kryeni një investim të madh për testimin (shihni këshillat e mëposhtme për testimin).

04. Programi i punës dhe i vlerësimit

Nëse nevojitet një Dokument i ri Evropian i Vlerësimit (EAD) apo nëse duhet të ndryshohet një dokument ekzistues, TAB-ja dhe prodhuesi përcaktojnë dhe bien dakord për **programin e punës dhe të vlerësimit**. Ky program do të marrë në konsideratë karakteristikat e produktit për të cilat prodhuesi dëshiron të deklarojë performancën dhe specifikimet teknike të harmonizuara përkatëse dhe të disponueshme.

Dokumenti Evropian i Vlerësimit hartohet dhe miratohet nga organizata e TAB-ve për çdo produkt ndërtimi që nuk mbulohet ose nuk mbulohet plotësisht nga një standard i harmonizuar, përtëcilin performancën lidhur me karakteristikat e tij themelore nuk mund të vlerësohet plotësisht sipas një standardi ekzistues të harmonizuar, për shkak se:

- a. produkti nuk bën pjesë në objektin e ndonjë standardi ekzistues të harmonizuar;
- b. për të paktën një karakteristikë themelore të atij produkti, metoda e vlerësimit e parashikuar në standardin e harmonizuar nuk është e përshtatshme; ose
- c. standardi i harmonizuar nuk parashikon asnjë metodë vlerësimi në lidhje me të paktën një karakteristikë themelore të atij produkti.

Procedura e miratimit të Dokumentit Evropian të Vlerësimit nga TAB-ja respekton parimet për hartimin dhe miratimin në bazë të nenit 21 të CPR-së:

- a. siguron transparencë për prodhuesin në fjalë;
- b. përcakton afate të përshtatshme kohore të detyrueshme për të shmangur vonesat e pajustificuara
- c. merr në konsideratë siç duhet ruajtjen e sekretit tregtar dhe të konfidencialitetit;
- d. lejon pjesëmarrjen e mjaftueshme të Komisionit;
- e. është me kosto efektive për prodhuesin; dhe
- f. siguron kolegjalitet dhe koordinim të mjaftueshëm midis TAB-ve të caktuara për produktin në fjalë.

TAB-të, së bashku me organizatën e TAB-ve, mbulojnë kostot e plota të hartimit dhe miratimit të Dokumenteve Evropiane të Vlerësimit. EAD-ja përmban, të paktën:

- një përshkrim të përgjithshëm të produktit të ndërtimit dhe të përdorimit të tij të synuar (kreu 1);
- listën e karakteristikave themelore që lidhen me përdorimin e synuar, metodat dhe kriteret për vlerësimin e performancës së produktit (kreu 2),

- parimet për zbatimin e sistemit të vlerësimit dhe vërtetimit të qëndrueshmërisë së performancës (kreu 3).

Afati kohor i zakonshëm për hartimin e një EAD-je të përcaktuar në Rregulloren për Produktet e Ndërtimit është 9 muaj. EAD-ja i jepet prodhuesit (kërkuesit) pa kosto shtesë. Ajo hartohet si pjesë e procedurës së ETA-s, në bazë të kërkesës. Kostot mbulohen nga EOTA dhe anëtarët e saj dhe bashkëfinancohet përmes granteve të BE-së.

AVANTAZH PËR TË GJITHË: Gjatë procedurës së hartimit të EAD-së, përmbajtja dhe madje edhe vetë fakti që po hartohet një EAD janë objekt i konfidencialitetit me kërkesë të prodhuesit. EOTA fillon ta bëjë EAD-në publikisht të disponueshme vetëm pasi të jetë lëshuar ETA-ja e parë.

Referencat ndaj EAD-ve përfundimtare shpallen në faqen e internetit të EOTA-s menjëherë pas lëshimit të ETA-s së parë.

Në fund, **referenca ndaj EAD-së publikohet nga Komisioni Evropian në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)** dhe përfshihet në NANDO. Menjëherë pas publikimit të referencës ndaj EAD-së në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, EOTA e vë në dispozicion tekstin e plotë të EAD-së përfundimtare në faqen e saj të internetit për shkarkim pa pagesë.

05. Lëshimi i ETA-s

Kur rezultatet e testit të kryer në bazë të EAD-së të jenë të disponueshme, TAB-ja do të hartojë një version draft të ETA-s që do të ndahet me kërkuesin, si dhe me TAB-të e tjera të caktuara për llojin përkatës të produktit, për të marrë përshtypjet e tyre. Bazuar në këto përshtypje, TAB-ja më pas do të lëshojë ETA-n.

Vlerësimi teknik evropian përfshin performancën e deklaruar sipas niveleve ose kategorive ose një përshkrim të atyre karakteristikave themelore të dakordësuara nga prodhuesi dhe TAB-ja që merr kërkesën për Vlerësimin Teknik Evropian për përdorimin e synuar të deklaruar, si dhe detajet teknike të nevojshme për zbatimin e sistemit të vlerësimit dhe vërtetimit të qëndrueshmërisë së performancës.

ETA-ja përbën bazën për Deklaratën e Performancës (DP-në), të cilën prodhuesi është i detyruar ta hartojë në përputhje me Rregulloren për Produktet e Ndërtimit (CPR-në) (të plotësohen të dhënat në lidhje me EAD-në, ETA-n dhe TAB-në në pikën 6.b të DP-së) përpara markimit CE të produktit të tij.



7.3 Kërkesat për organet e vlerësimit teknik (TAB-të)

TAB-ja kryen vlerësimin dhe lëshon Vlerësimin Teknik Evropian për llojin e produktit për të cilën ajo është caktuar. TAB-ja përmbush kërkesat e përcaktuara në tabelën 2 të shtojcës IV brenda objektit të caktimit të saj.

Kompetenca	Përshkrimi i kompetencës	Kërkesa
1. Analizimi i rreziqeve	Identifikimi i rreziqeve dhe avantazheve të mundshme që sjell përdorimi i produkteve novatore të ndërtimit në mungesë të informacionit teknik të vërtetuar/të konsoliduar në lidhje me performancën e tyre kur instalohen në punimet e ndërtimit.	TAB-ja krijohet në bazë të së drejtës së brendshme dhe ka personalitet juridik. Ajo është e pavarur nga grupet e interesit dhe nga çdo interes i veçantë. Gjithashtu, TAB-ja ka një staf me: (a) objektivitet dhe gjykim të shëndoshë teknik; (b) njohuri të detajuara mbi dispozitat rregullatore dhe kërkesat e tjera në fuqi në shtetet anëtare ku është caktuar, për sa u përket llojeve të produkteve për të cilat caktohet; (c) njohje të përgjithshme të praktikës së ndërtimit dhe njohuri teknike të detajuara në lidhje me llojet e produkteve për të cilat caktohet; (d) njohuri të detajuara rreth rreziqeve specifike të përfshira dhe aspekteve teknike të procesit të ndërtimit; (e) njohuri të detajuara rreth standardeve ekzistuese të harmonizuara dhe metodave të testimit për llojet e produkteve për të cilat caktohet; (f) aftësitë e duhura gjuhësore.
2. Përcaktimi i kritereve teknike	Përkthimi i rezultateve të analizës së rrezikut në kritere teknike për vlerësimin e sjelljes dhe performancës së produkteve të ndërtimit në lidhje me përmbushjen e kërkesave kombëtare të zbatueshme; Sigurimi i informacionit teknik të nevojshëm nga ata që marrin pjesë në procesin e ndërtimit si përdorues të mundshëm të produkteve të ndërtimit (prodhuesit, projektuesit, kontraktorët, instaluesit).	Kompensimi i personelit të TAB-së nuk varet nga numri i vlerësimeve të kryera apo nga rezultati i këtyre vlerësimeve.
3. Përcaktimi i metodave të vlerësimit	Projektimi dhe validimi i metodave të duhura (testeve ose llogaritjeve) për vlerësimin e performancës së karakteristikave themelore të produkteve të ndërtimit, duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të artikullit.	
4. Përcaktimi i kontrollit specifik të prodhimit në fabrikë	Njohja dhe vlerësimi i procesit të prodhimit të produktit specifik me qëllim identifikimin e masave të duhura për të garantuar qëndrueshmërinë e produktit gjatë procesit përkatës të prodhimit.	TAB-ja ka një staf me njohuritë e duhura mbi marrëdhënien midis proceseve të prodhimit dhe karakteristikave të produktit në lidhje me kontrollin e prodhimit në fabrikë.
5. Vlerësimi i produktit	Vlerësimi i performancës së karakteristikave themelore të produkteve të ndërtimit përkundrejt kritereve të harmonizuara, mbi bazën e metodave të harmonizuara.	Krahas kërkesave të renditura në pikat 1, 2 dhe 3, TAB-ja ka gjithashtu akses në mjetet dhe pajisjet e nevojshme për vlerësimin e performancës së karakteristikave themelore të produkteve të ndërtimit që u përkasin llojeve të produkteve për të cilat ajo caktohet.
6. Menaxhimi i përgjithshëm	Garantimi i konsistencës, besueshmërisë, objektivitetit dhe gjurmueshmërisë përmes zbatimit të vazhdueshëm të metodave të duhura të menaxhimit.	TAB-ja ka: (a) një sjellje të respektueshme dhe të mirë të dëshmuar nga ana e administratës së saj; (b) një politikë dhe procedurë mbështetëse për garantimin e konfidencialitetit të informacionit sensitiv brenda TAB-së dhe të gjithë partnerëve të saj; (c) një sistem të kontrollit të dokumenteve për të garantuar regjistrimin, gjurmueshmërinë, ruajtjen dhe arkivimin e të gjitha dokumenteve; (d) një mekanizëm për auditim të brendshëm dhe shqyrtim nga niveli drejtues për të siguruar monitorim të rregullt të pajtueshmërisë me metodat e duhura të menaxhimit; (e) një procedurë për të trajtuar në mënyrë objektive apelit dhe ankesat.

Tabela 2: Kërkesat për TAB-të (shtojca IV e CPR-së)

TAB-ja vë në dispozicion të publikut organigramën e saj dhe emrat e anëtarëve të organeve të saj të brendshme vendimmarrëse.

Kur një TAB nuk është më në përputhje me kërkesat, shteti anëtar tërheq caktimin e asaj TAB-je për llojin përkatës të produkteve dhe informon Komisionin dhe shtetet e tjera anëtare për këtë.

8. AKSESI NË TREGUN E BRENDSHËM TË BE-SË

Qëllimi i Tregut të Brendshëm të BE-së është ekzistenca e një zone pa kufij të brendshëm apo pengesa rregullatore, në të cilën sigurohet lëvizja e lirë e mallrave, njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit, në përputhje me nenet e traktateve. Vendet kandidatë dhe ato potencialisht kandidatë në rajonin e CEFTA-s kërkojnë gjithashtu ta përafrojnë legjislacionin e tyre me tërësinë e legjislacionit të BE-së, si një nga kushtet për anëtarësimin e tyre të ardhshëm në BE.

8.1 Lëvizja e lirë e mallrave

Lëvizja e lirë e mallrave sigurohet nëpërmjet **heqjes së detyrimeve doganore** dhe **kufizimeve sasiore** dhe ndalimit të masave që kanë një efekt të barasvlershëm. **Parimet e njohjes së ndërsjellë**, eliminimit të pengesave fizike dhe teknike dhe promovimit të standardizimit janë shtuar me qëllim vazhdimësinë e plotësimin të tregut të brendshëm. Miratimi i kuadrit të ri legjislativ në vitin 2008 i dha shtysë lëvizjes së lirë të mallrave, sistemit të mbikëqyrjes së tregut të BE-së dhe markimit CE. **Baza ligjore** është neni 26 dhe nenet 28 - 37 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

E drejta e lëvizjes së lirë të mallrave me origjinë nga shtetet anëtare të BE-së dhe mallrave me origjinë nga vendet e treta që janë në qarkullim të lirë në shtetet anëtare përbën një nga parimet themelore të

traktatit (neni 28 i TFBE-së). Fillimisht, lëvizja e lirë e mallrave shihej në prizmin e një bashkimi doganor midis shteteve anëtare, që përfshinte heqjen e detyrimeve doganore, kufizimeve sasiore mbi tregtinë dhe masave të barasvlershme dhe vendosjen e një tarife të jashtme të përbashkët për Bashkimin Evropian. Më vonë, theksi u vu në eliminimin e të gjitha pengesave të mbetura ndaj lëvizjes së lirë të mallrave, me qëllim **krijimin e tregut të brendshëm**.

Miratimi i ligjeve harmonizuese ka bërë të mundur **heqjen e pengesave** (për shembull, duke i bërë të pazbatueshme dispozitat kombëtare) dhe **vendosjen e rregullave të përbashkëta** që synojnë **garantimin e qarkullimit të lirë të mallrave dhe produkteve**.

8.2 Njohja e ndërsjellë

Parimi buron nga nenet 34-36 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe shtjellohet më tej në **Rregulloren (BE) 2019/515**⁷ "Për njohjen e ndërsjellë të të gjitha mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një tjetër shtet anëtar". Qëllimi i Rregullores (BE) 2019/515 është forcimi i funksionimit të tregut të brendshëm të BE-së duke përmirësuar zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë dhe duke hequr pengesat e pajustificuara ndaj

tregtisë. Ajo përcakton të drejtat dhe detyrimet në lidhje me parimin e njohjes së ndërsjellë për autoritetet kompetente dhe prodhuesit në rast të shitjes së

- mallrave jo të harmonizuara që janë në përputhje me rregullat përkatëse të zbatueshme ose që nuk u nënshtrohen rregullave në atë shtet anëtar dhe
- që u vihen në dispozicion përdoruesve fundorë në atë shtet anëtar.

⁷ <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/515/oj>

⁸ Rregullorja 2019/515 zbatohet nga data 19 prill 2020 dhe zëvendëson Rregulloren (KE) nr. 764/2008.

Meqenëse të gjitha produktet e ndërtimit mund të pajisen me markimin CE në bazë të regjimit të CPR-së, faktori i rëndësishëm për të përcaktuar nëse një produkt ndërtimi bën pjesë në objektin e parimit të njohjes së ndërsjellë është prania ose mungesa e markimit CE. Vetëm ato produkte të cilat nuk mbartin markimin CE bëjnë pjesë në objektin

e këtij parimi dhe pasojat procedurale të tij. Produktet e ndërtimit që mbartin markimin CE duhet të trajtohen në përputhje me dispozitat e CPR-së.

Vendet e BE-së duhet të japin informacion mbi rregullat dhe rregulloret e tyre për produktet e ndërtimit përmes [pikave kombëtare të kontaktit për produktet](#)⁹.

8.3 Pikat e kontaktit të produkteve për produktet e ndërtimit – Neni 10

NVM-të mund të marrin informacione të besueshme dhe specifike në lidhje me legjislacionin në fuqi pranë pikave të kontaktit të produkteve, duke përfshirë pikat e kontaktit për produktet e ndërtimit, të vendosura në çdo shtet anëtar. Roli i pikave të kontaktit të produkteve është dhënia e informacioneve mbi të gjitha rregullat që lidhen me produktet, duke përfshirë rregullat teknike kombëtare që mbulohen nga njohja e ndërsjellë dhe dispozitat brenda territorit të tyre që synojnë përmbushjen e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit që zbatohen për përdorimin e synuar të çdo produkti ndërtimi. Ato sigurojnë që pikat e kontaktit

të produkteve të ofrojnë shërbimet e tyre në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1724 dhe me [Rregulloren \(BE\) 2019/515](#).

Pikat e kontaktit të produkteve për produktet e ndërtimit duhet të japin gjithashtu informacione mbi rregullat e zbatueshme për integrimin, montimin ose instalimin e një lloji specifik produkti ndërtimi.

Pikat e kontaktit të produkteve për produktet e ndërtimit janë të afta t'i kryejnë funksionet e tyre në një mënyrë që parandalon konfliktet e interesit, veçanërisht ato në lidhje me procedurat për marrjen e markimit CE.

8.4 Dokumenti udhëzues për zbatimin e Rregullores (BE) 2019/515

Parimi i njohjes së ndërsjellë dhe procedurat për produktet jo të harmonizuara specifikohen në një [dokument udhëzues evropian për zbatimin e Rregullores \(BE\) 2019/515 "Për njohjen e ndërsjellë të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një tjetër shtet anëtar \(dhe për shfuqizimin e Rregullores \(KE\) nr. 764/2008\)".](#)

- Kriteri i parë është që mallrat ose mallrat e atij lloji duhet të jenë në përputhje me rregullat përkatëse të zbatueshme në shtetin anëtar të origjinës ose nuk duhet t'u nënshtrohen rregullave të atij shteti anëtar.

Kur ka rregulla teknike kombëtare në shtetin anëtar të origjinës, informacioni lidhur me

karakteristikat e mallrave dhe referencat ndaj legjislacionit të brendshëm mund të jenë, në disa raste, të mjaftueshme për të dëshmuar pajtueshmërinë. Në raste të tjera, **mund të nevojitet një vendim për autorizim paraprak**.

- Kriteri i dytë i konceptit të tregtimit të ligjshëm është **që mallrat të jenë vënë në dispozicion të përdoruesve fundorë** në atë shtet anëtar.

Përdorimi i instrumenteve tregtare mbrojtëse nga BE-ja bazohet në rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë. BE-ja përdor këto instrumente dhe zbaton edhe një sërë kushtesh të tjera krahas rregullave OBT-së për të siguruar përdorimin e tyre të përshtatshëm.

9. MBIKËQYRJA E TREGUT dhe PRODUKTET E RREZIKSHME

Institucionet e mbikëqyrjes së tregut kanë funksionuar në të gjitha shtetet palë të CEFTA-s që prej miratimit të Rregullores 765/2008/KE dhe zbatimit të saj strukturat dhe aktivitetet e tyre vendore të mbikëqyrjes së tregut, funksionim i cili është theksuar edhe më tej me zbatimin e Rregullores (BE) nr. 2019/1020.

Mbikëqyrja e tregut është me rëndësi thelbësore për funksionimin pa probleme të [tregut të vetëm](#) dhe mund të jetë e formës proaktive ose reaktive. Në të dyja format e saj, ajo ndihmon në mbrojtjen e

- konsumatorëve, përdoruesve fundorë dhe punëtorëve nga produktet e pasigurta dhe papajtueshmëria e përgjithshme dhe
- bizneseve nga konkurrenca e pandershme e atyre që shpërfillin rregullat.

Legjislacioni i BE-së për mbikëqyrjen e tregut¹⁰ parashikon

- rregulla të qarta dhe uniforme që zbatohen për produktet joushqimore dhe operatorët ekonomikë,
- kërkesa (lidhur me infrastrukturën, organizimin, tagrat ligjore etj.) për të siguruar që mbikëqyrja e tregut të mund të përballojë zbatimin e legjislacionit të BE-së,
- procedura efikase të mbikëqyrjes së tregut për kontrollin e produkteve brenda BE-së dhe në kufijtë e saj (kontrollët e importit),
- mjete për koordinimin e aktiviteteve të kryera nga organet kombëtare të mbikëqyrjes anembanë BE-së (p.sh. forumet e diskutimit, bazat e të dhënave të TI-së dhe fushatat e përbashkëta të mbikëqyrjes së tregut).

Në shumicën e shteteve palë të CEFTA-s

ekzistojnë sisteme raportimi për pajisjet e papajtueshme dhe ato me rrezikshmëri të lartë, ndonëse mund të mos jenë plotësisht në përputhje me sistemet e ngjashme të BE-së,¹¹ ICSMS dhe Safety Gate (ish-RAPEX, shihni seksionin 10.1/10.2). Një arsye mund të jetë fakti se vendet jo anëtare të BE-së nuk mund t'i përdorin plotësisht sistemet e informacionit të BE-së. Një nga shtetet palë të CEFTA-s po zhvillon një QMS për mbikëqyrjen e tregut dhe ka raportuar përaftrim të vazhdueshëm të legjislacionit të saj me Rregulloren (BE) nr. 2019/1020.

Qëllimi [Rregullores \(BE\) nr. 2019/1020 “Për mbikëqyrjen e tregut dhe pajtueshmërinë e produkteve”](#) është¹²:

- të përmirësojë mënyrën e funksionimit të parimit të lëvizjes së lirë të mallrave duke forcuar mbikëqyrjen e tregut* të produkteve të mbuluara nga legjislacioni harmonizues i BE-së. Kjo duhet të garantojë një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë, si në përgjithësi ashtu edhe në vendin e punës, si dhe të mbrojë konsumatorët, mjedisin, sigurinë publike dhe interesat e tjera publike,
- të përcaktojë rregullat dhe procedurat për operatorët ekonomikë <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/market-surveillance-and-compliance-of-products.html> edhe të krijojë një sistem për bashkëpunimin e tyre me autoritetet mbikëqyrëse,
- të vendosë kontrolle mbi produktet e importuara në BE.

Ai fshin dhe zëvendëson nenet 15 deri në 29 të Rregullores (KE) nr. [765/2008](#) (shihni përmbledhjen për [akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut](#)) dhe ndryshon Direktivën për Makineritë dhe Rregulloren (BE) nr. 305/2011 “Për produktet e ndërtimit”.

10 https://single-market-economy.ec.europa.eu/single-market/goods/building-blocks/market-surveillance_en

11 ICSMS (Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit për Mbikëqyrjen e Tregut) është platforma gjithëpërfshirëse e komunikimit për mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe për njohjen e ndërsjellë të mallrave.

12 <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/1020/oj>

9.1 Shkëmbimi i shpejtë i informacionit për produktet e rrezikshme (Safety Gate, ish- baza e të dhënave RAPEX)

RAPEX ishte sistemi i parë i sinjalizimit të shpejtë i Bashkimit Evropian, i krijuar për të adresuar produktet e pasigurta të konsumit dhe për të rritur mbrojtjen e konsumatorit, i cili lehtësonte shkëmbimin e shpejtë të informacionit midis shteteve anëtare të BE-së dhe Komisionit Evropian, duke u fokusuar në masat e marra për të parandaluar ose kufizuar tregtimin ose përdorimin e produkteve të konsumit që paraqesin **rrezik të madh** për konsumatorët.

Sistemi i shkëmbimit të shpejtë mundëson shpërndarjen e shpejtë të informacionit në lidhje me tërheqjen e produkteve, riatdhesimin dhe masat e tjera të lidhura me sigurinë, që mund të merren me nismën e autoriteteve kombëtare ose vullnetarisht nga prodhuesit dhe shpërndarësit e produkteve të rrezikshme, dhe siguron që palët përkatëse të qëndrojnë të informuara lidhur me produktet e pasigurta dhe të marrin masat e nevojshme paraprake.

Thënë ndryshe, RAPEX luan një rol thelbësor për ruajtjen e sigurisë së konsumatorëve duke adresuar me shpejtësi rreziqet që lidhen me produkte të ndryshme në tregun e BE-së. Në fund të vitit 2024, RAPEX do të zëvendësohet me faqen e internetit Safety Gate, për të rritur efektivitetin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve. Platforma e re Safety Gate vazhdon misionin e RAPEX duke dhënë informacione të përditësuara mbi produktet e pasigurta të konsumit. Ajo përfshin produktet e mbuluara nga Rregullorja (BE) nr. 2019/1020 (akreditimi dhe mbikëqyrja e tregut të produkteve joushqimore).

9.1.1. Projekti SEED+

Në shtetet palë të CEFTA-s, disa aktivitete të mbikëqyrjes së tregut po harmonizohen me kuadrin e ri legjislativ të BE-së, veçanërisht për produktet me rrezik të lartë ose ato të papajtueshme, duke përfshirë përdorimin e një baze të dhënash të përbashkët për performancat e pamjaftueshme, produktet e papajtueshme dhe produktet e rrezikshme. Një prej tyre është **baza e të dhënave SEED+**, e cila bazohet në modelin e Safety Gate

dhe është krijuar për produktet e pasigurta/ të papajtueshme të konstatuara në tregun e CEFTA-s. Që prej dhjetorit të vitit 2023, baza e të dhënave është plotësisht funksionale dhe shërben si një bazë e përbashkët të dhënash që mundëson shkëmbimin e rregullt dhe sistematik të të dhënave për produktet e pasigurta në rajon dhe u vjen në ndihmë autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, prodhuesve dhe OVK-ve.

10. UDHËZIME TË MËTEJSHME PËR PËRDORIMIN E CPR-SË SË RE

Rishikimi i ardhshëm synon të përfshijë elementet e qëndrueshmërisë të përfshira në Paktin e Gjelbër të vitit 2019 dhe të shtjelluara më tej në planin e veprimit të ekonomisë qarkulluese të miratuar në vitin 2020. Programi i punës i Komisionit për vitin 2021 parashikonte fillimisht rishikimin e CPR-së për tremujorin e tretë të atij viti, por më pas ky rishikim u shty për në fund të marsit të vitit 2023.

Më 30 mars 2022, Komisioni Evropian paraqiti një propozim për rishikimin e CPR-së. Teksti u diskutua në Parlamentin Evropian dhe në Këshill. Më 10 prill 2024, Parlamenti Evropian i dha përfundimisht dritën e gjelbër rregullore për produktet e ndërtimit që synon të nxisë dixhitalizimin, harmonizimin dhe qëndrueshmërinë në sektorin e ndërtimit. Tani, mbetet që Këshilli t'i japë rregullore së re miratimin e tij përfundimtar zyrtar. Pas kësaj, teksti do të publikohet në Gazetën Zyrtare dhe do të hyjë në fuqi.

Propozimi i Komisionit [për CPR-në e re](#)¹⁴ përfshin ndryshimet kryesore të mëposhtme krahasuar me CPR-në ekzistuese:

- objekti riformulohet dhe produktet e ndërtimit të ripërdorura dhe të ndërtuara me printer 3D (në përkufizimin e produktit të ndërtimit), si dhe banesat e parafabrikuara dhe ato ku banon vetëm një familje, përfshihen si një familje produktesh,
- Komisioni do të lejohet të miratojë specifikime teknike në rastet kur sistemi i standardizimit nuk jep rezultatet e pritshme, si dhe të përcaktojë kërkesat për produktin (neni 5),
- përcakton kërkesa të reja mjedisore, funksionale dhe sigurie për produktet e ndërtimit dhe punimet e ndërtimit (në shtojcën I - Kërkesat bazë për punimet e ndërtimit, shtojcën II, shtojcën III – Kërkesat për produktet, dhe shtojcën IX në sistemin AVCP shtesë 3+: Kontrolli nga organi i notifikuar i vlerësimit të qëndrueshmërisë mjedisore),
- krijon një "zonë të harmonizuar" (në vend

të zonave nën përgjegjësinë e shteteve anëtare) dhe një mekanizëm për të trajtuar me "nevojat e domosdoshme rregullore" të shteteve anëtare për shëndetin, sigurinë ose mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe klimën (neni 11),

- krijon një detyrim të ri për prodhuesit (neni 20, 21, 22), veçanërisht për dhënien e një deklarate performance (në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat për produktin) dhe paraqet mundësinë për dhënie të informacionit përmes mjeteve elektronike (neni 16),
- krijon detyrime më specifike për të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë (përfaqësuesit e autorizuar, importuesit dhe shpërndarësit) dhe për bashkëpunimin midis tyre (kreu III),
- përcakton një listë të kërkesave të përgjithshme të qëndrueshmërisë që do të detajohen më tej në aktet e Komisionit/standardet e harmonizuara (shtojca X),
- prezanton dispozita thjeshtuese dhe përjashtimore për mikro-ndërmarrjet (shtojca VII) dhe përjashtimin nga hartimi i një DP-je (neni 14),
- forcon kompetencat zbatuese të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut (kreu VIII),
- fuqizon pikat e kontaktit të produkteve për produktet e ndërtimit, për të mbështetur më mirë operatorët ekonomikë (neni 72),
- krijon një sistem të ri të Komisionit që lejon çdo person fizik ose juridik të ndajë ankesa ose raporte në lidhje me shkeljet e mundshme të rregullores (neni 63 dhe 71), dhe së fundi, por jo për nga rëndësia,
- bën harmonizimin me rregulloren e propozuar për kërkesat e eko-dizajnit për produkte të qëndrueshme, me në fokus klimën dhe qëndrueshmërinë mjedisore dhe pasaportën dixhitale të produktit (shih kreun X dhe nenin 75 dhe 76).

Përpara zbatimit të rregullave të një CPR-je të re, rekomandohet të kontrollohet tabela e përputhshmërisë.

13 [https://www.europarl.europa.eu/RegData/docs_autres_institutions/commission_europeenne/com/2022/0144/COM_COM\(2022\)0144_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/docs_autres_institutions/commission_europeenne/com/2022/0144/COM_COM(2022)0144_EN.pdf)

14 https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2024-0188_EN.html#title2

11. BIBLIOGRAFIA

Rregullorja për Produktet e Ndërtimit

[Rregullorja - 305/2011 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)

Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) nr. 568/2014 "Për vlerësimin dhe vërtetimin e qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit"

[Rregullorja e Deleguar - 568/2014 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)

Rregullorja e Deleguar (BE) nr. 574/2014 "Për modelin që do të përdoret për hartimin e një deklarate të performancës për produktet e ndërtimit"

[Rregullorja e Deleguar - 574/2014 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)

Lista e standardeve të harmonizuara sipas rregullores për produktet e ndërtimit

[Lista e hEN-ve sipas CPR-së](#)

Lista e pyetjeve më të shpeshta në lidhje me CPR-në

[ea-2-17-m.pdf \(european-accreditation.org\)](#)

[Përmbledhje të legjislacionit të BE-së - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)

PËRMBLEDHJE MBI [akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut](#)

[Akreditimi i organeve të vlerësimit të konformitetit në Bashkimin Evropian \(europa.eu\)](#)

Baza e të dhënave të NANDO

[EUROPA - Komisioni Evropian - Rritja - Politika rregullatore - NANDO](#)

QENDRA E INFORMACIONIT E CEFTA-S

<https://cefta.int/trade-info-center/>

PORTALI TREGTAR I CEFTA-S

<https://transparency.cefta.int/TradePortal>

MARRËVESHJET DYPALËSHE

<https://transparency.cefta.int/SPSSideTables/InternationalAgreements>

EOTA

<https://www.eota.eu/about-us>

ETAs

<https://www.eota.eu/what-is-an-eta>

EAD

<https://www.eota.eu/what-ead>

Published by:

Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Registered offices:

Bonn and Eschborn, Germany

Project:

Open Regional Fund for Southeast Europe -
Foreign Trade

Giz Office Sarajevo

Zmaja od Bosne 7- 7a, Importanne Centar 3/IV

Contact:

T +387 33 957 500 F +387 33 957 501

GIZ-BosnienHerzegovina@giz.de

www.giz.de/bosnia-herzegovina

Design/Layout: BORAM

Photo credits @GIZ, @Shutterstock


The programme is co-funded by the European
Union and the German Federal Ministry for
Economic Cooperation and Development
(BMZ).

GIZ is responsible for the content of this
publication.

As at: 2023, Sarajevo

Udhëzime për produktet e ndërtimit

Udhëzime për zbatimin e Rregullores së BE-së për
Produktet e Ndërtimit (2011/305/BE)



This publication was produced with the financial support of the European Union and the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ). Its contents are the sole responsibility of GIZ and do not necessarily reflect the views of the EU or the Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ).



Implemented by

